

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 15.12.2025, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Dhjetor 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sot kemi mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin dhjetor dhe të fundit për vitin 2025, me rend dite si më poshtë:

1. Projekt vendim "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit për vitin 2026"
2. Projekt vendim "Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027"
3. Projekt vendim "Për lënien në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm"
4. Projekt vendim "Për miratimin e listës së familjeve që përftojnë subvencionin e qirasë për vitin 2026"
5. Projekt vendim "Për miratimin e vlerës së grantit të menjëhershëm për pesë familjet përfituese të programit të subvencionit të interesave të kredisë me vlerë 1.842.784 lekë"
6. Projekt vendim "Për miratimin e bursave të nxënësve të regjistruar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026"
7. Projekt vendim "Për miratimin e bursave të nxënësve të klasave të 10-ta të arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2025-2026"
8. Projekt vendim "Për rishqyrtimin dhe miratimin e bursave të nxënësve të viteve të ndërmjetme, të shkollës së mesme profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë, për vitin shkollor 2025-2026"
9. Projekt vendim "Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. N.M. për djegie banese"
10. Projekt vendim "Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare për përmbytje në banesë z. B.Ll., z. L.D., z. Gj.G., z. P.P., z. B.Rr., z. P.T., z. N.K., z. A.M., z. G.D."
11. Projekt vendim "Për krijimin e "Muzeut Arkeologjik Lezhë", në lokalitetin e njohur si "Qafa e Kalasë" dhe pranë "Nekropolit Mesjetar"

Përveç këtyre kemi një projektvendim shtesë, i cili për arsye teknike nuk është paraqitur në kohë, që është projektvendimi "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-30 Nëntor 2025".

Kush është dakord me rendin e ditës? Zonja Ndoj ka fjalën për procedurë.

-Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve! Në fakt, ajo që më bëri përshtypje ishte se zarfi mua sot në mëngjes më ka arritur dhe e kam marrë në dorë kur po shkoja në punë. Zarfi për këshillin sot edhe normal që kjo është një vonesë dhe nuk e di cila është arsyeja pse zarfi për këshilltarët ka ardhë me vonesë. Nuk e di nëse mund t'i ketë ndodhur ndonjë këshilltari tjetër.

-Ndue Luli: Është e drejtë kjo që thoni ju. Kush është tjetër që do të flasë, pastaj përgjigjen. Ka ndonjë tjetër? Atëherë edhe këshilltarit Alfons Trashaj nuk i paska shkuar. Edhe ju, domethënë tre këshilltarëve. Në një kohë, sa për dijeni, ju e dini për projektbuxhetin është zbatuar tamam ligji për njoftimin, minimumi dy javor për projektbuxhetin që kemi për vitin 2026, kurse pikat e tjera të rendit të ditës janë njoftuar pesë ditë përpara sesa të kemi mbledhjen dhe pikërisht ditën e njoftimit janë shpërndarë dhe zarfat. Kjo qenka ndonjë pengesë që ka të bëjë me postën, ku na ngelet detyrë neve si kryesi këshilli që ta kërkojmë një gjë të tillë edhe nëpërmjet postës, flas për dokumentacionin e mbledhjes fizikisht. Kurse elektronikisht jam i bindur që secili nga ju i ka marrë në kohë.

-Donika Ndoj: Edhe diçka tjetër: zarfi shumë i madh në proporcion me letrën A4. Unë mendoj që të shikohet dhe si zarf shumë i madh, se që këtu fillon pak buxheti, shpenzimi pak i tepërt.

-Ndue Luli: Edhe këtë do ta kemi parasysh.

Zoti Artan e ka fjalën për procedurë.

-Artan Ndreu: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! I uroj kryetarit të bashkisë edhe 100 të tjera se ka pasë ditëlindjen. Meqë jemi në mbledhjen e fundit, ashtu siç e tha dhe kryetari i këshillit, për mua është mbledhja e fundit, po më e rëndësishmja, se miratojmë buxhetin më të madh të 35 viteve. Dhe meqë kryetari i bashkisë ka filluar dhe projekte të mëdha, tashi mbi 10 milionë euro

-Ndue Luli: Zoti Artan, të lutem për procedurë se ende s'kemi miratuar rendin e ditës për të filluar diskutimin.

-Artan Ndreu: Meqë ka filluar me projektin me vlerë 10 milionë, kryetari i bashkisë, në qoftë se pranon, do t'i bëj kërkesë a sugjerim, lutje, si të dojë, por përgjigjen nuk e dua sot, e dua ditën që të bëjë betimin e mandatit të tretë, e përgjigjen nëse pranon, unë do t'ia them që ka bërë rrugë, ka bërë kanale, e ka bërë ujësjellësa, ka bërë shumë gjëra. Se po të rri nja tre ditë t'i përmend se çfarë ka bërë, po unë kam qejf që modeli i zotit Ndreu të jetë si model edhe kur të mos jetë ky kryetar bashkie. Atë që do them unë vetëm dy vetë kanë fuqi politike që mund ta bëjnë në Shqipëri. Mund ta bëjë Edi Rama dhe Pjerin Ndreu, nuk do shumë shpenzime. Edhe këtë ëndrrën që kam unë, e kanë zili shtete të fuqishme.

-Ndue Luli: Të lutem, përfundoje!

-Artan Ndreu: Po prit o kryetar, dy minuta marr gjithë vitin unë. Zoti kryetar, ta shpalos kërkesën.

-Ndue Luli: Kur të fillojmë diskutimin e projektbuxhetit mund ta shpalosësh, zoti Artan.

-Artan Ndreu: Falë zotit është një pozicion gjeografik shumë i mirë. Zoti kryetar i Bashkisë, thashë dhe një herë, e dua përgjigjen ditën që të bësh betimin e mandatit të tretë. Dua që të na

vesh në funksion Portin e Shëngjinit dhe aeroportin e Gjadrit. Thashë, dy veta e bëjnë këtë punë, Edi Rama dhe Pjerin Ndreu, Edi Ramën s'kam ku me e taku.

-Pjerin Ndreu: Njëra ka marrë rrugë, tjetra ta shohim.

-Artan Ndreu: Edhe ajo e ujit, në qoftë se do i realizosh këto dy kërkesat imagjinare të miat, ti do të mbetesh shumë afër dy Gjergjave që kena Gjergj Kastriotit dhe Gjergj Fishtës. Më besoni, ore, kanë zili shtete që të kenë edhe port, edhe aeroport. Faleminderit për durimin.

-Ndue Luli: Faleminderit Artan.

Atëherë, kush është dakord me projektvendimet e ditës së sotme, në rendin e ditës? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota Pro. Faleminderit!

Vazhdojmë me projektvendimin e parë, që ka të bëjë me miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026.

Në lidhje me projektbuxhetin, fjalën e ka zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Po, faleminderit kryetar. Përshëndetje të gjithë këshilltarëve të pranishëm sot këtu. Normalisht, duke qenë edhe mbledhja e fundit e vitit, është edhe më e rëndësishmja, sepse ka të bëjë me projektbuxhetin, atë që ne kemi plan për të bërë. Me pak fjalë do t'i shpjegoj disa orientime kryesore, pastaj nëpërmjet pyetjeve, nëpërmjet diskutimeve, ne mund t'i sqarojmë gjërat në proces, jemi të hapur që të diskutojmë. Atëherë, këtë vit ne vijmë me një buxhet, kuptohet, me rritje. Vijmë me 25 miliardë. Jemi me një buxhet të fokusuar kryesisht tek infrastruktura rrugore. Ne hyjmë masivisht në rikuperimin e një historie, e cila është një plagë e patrajtuar ose e trajtuar në mënyrë fragmentare, me pjesë, jo një projekt i plotë. Por ne pak a shumë adresojmë një projekt që shkon në 70% të studimit të problematikës së infrastrukturës urbane dhe rurale. Jo pa qëllim është bërë kjo, duke qenë një vend turistik, e duke qenë një zonë e cila tashmë po zhvillohet dhe nuk mund të ekzistojë pa infrastrukturën rrugore. Vetë zhvillimi, vetë turizmi e kërkon si domosdoshmëri, duke pasur parasysh edhe një shtrirje të aseteve turistike në të gjithë territorin e bashkisë, jo vetëm bregdetit. Ne hyjmë në një program për investimin në 112 rrugë, rrugë urbane dhe rurale. Pra, ne hyjmë në një sistem me 57.2 km, ku 20 km janë vetëm brenda qytetit. 20 km brenda qytetit fillojnë tani me datën tre ne kemi firmosur kontratën tashmë, është shpallur fituesi. Ne fillojmë në lagjen Frutore, fillojmë tek rruga Demokracia tek Fiqtë, fillojmë tek Gurrat sipër, tek shtëpitë private, fillojmë në lagjen Kodërmarleka. Nëse do na japë lejen kompania që po merret me ujësjellësin, që ne të ndërhyjmë, megjithëse po, por do hyjmë në të gjitha rrugët që nuk ndërhyjnë KFË-ja, dhe vazhdojmë me 37 km rrugë rurale. Peshën më të madhe të rrugëve, në përqindje sipas kësaj, e merr njësia e Zejmenit, në përqindje thashë. Për arsye të ndryshme, për shembull, Kolshi i bie që ne kemi planizu Manati, Grykë Manati ujësjellësin dhe pretendojmë që ta marrim si financim këtë vit. Të jemi të qartë për disa gjëra, se thonë pse ky, pse ai, dhe ne jemi të detyruar të dalim nga sistemi i bërjes së disa rrugë për arsye të ujësjellësit, që normalisht është ajo historia sikur e kemi bërë në lagjen "Nënë Tereza", ku nuk kemi bërë asnjë rrugë për arsye të punimeve nëntokësore. S'ka kuptim të shpenzojmë lekë dhe të shkojmë t'i hapim prapë pastaj. Kemi problem njësinë e Balldenit për disa kombinacione që kemi aty. E para, fusha e Torovicës është në fokusin e një diskutimi komplet, me një konsorcium amerikan të cilët do vijnë, besoj, pas janarit. Synimi i tyre është që të ndërtojnë një kompani blegtorie, bylmeti me të paktën 150 milionë euro, ku do hyjnë në gjithë infrastrukturën, jo vetëm rrugore, por edhe të objekteve të

tjera sociale, kulturore. Unë jam ulur me ta, i kam diskutuar në Amerikë. I presim me ardhë këtu, i kemi çuar ato të dhënat, çfarë duan, mendoj se gjithë zona e Torovicës duhet të transformohet në një tjetër histori. Presim deri në prill, maj, ndërkohë që Gocaj-Kakarriqi është në ujësjellës dhe akoma nuk kemi përgjigje nga kompania. E kemi lënë të hapur, nëse kompania do na japë ne me tepricat që do rialokojmë në mars, ne do të hyjmë në një investim total të gjithë zonës, ku është bërë ujësjellësi fillimisht në Gocaj-Kakarriq, për ta transformuar ashtu siç do hyjmë te lagjja NënëTereza. Do bëjmë një ndryshim në Zejmen. Nëse duhet, do heqim dy rrugë që s'janë të domosdoshme për t'i futur po me tepricat në mars, për arsye se na duhet të hyjmë në rrugën e Kalivaçit në Ungrej, e cila vitet e fundit është pothuajse zero. Të gjitha njësitë e tjera, njësia e Shënkollit bashkë me dy ishujt, bashkë me Barbullojën hyjnë në projektin e qeverisë. Pra, përveç këtij projekti që kemi ne këtu, kemi edhe 10 miliardë të dhëna nga qeveria tashmë për pallatin e sportit dhe për rrugë rurale. Siç kemi premtuar, unë jam marrë me kryeministrin. Do vijnë pra 10 miliardë të tjera që vijnë përveç kësaj, edhe 2 miliardë që vijnë te qendra e moshës së tretë. Pra, po t'i shikojmë në syrin e lekëve që implementohen në ekonomi, s'po them Milot-Balldreni që duhet të shpallet tashmë për arsye të turbulencave që ju e dini. Bypass-i i Shëngjinit, që ka filluar, ka dhe lejen, ju them juve të opozitës, ka leje edhe është financimi i Fondit të Zhvillimit. Do vazhdojmë me një projekt të ri, dy projekte të reja që vijnë automatikisht. Vjen formula e re e pastrimit, ku ne si bashki, ne kemi prokuruar mjetet që do vijnë, kemi ndërtuar dhe strukturën me një ndërmarrje më vete. Normalisht që për pasojë rritet edhe numri i punonjësve, sepse ato lekë që i kemi pas çuar atje do t'i përdorim tashmë vetë brenda përbrenda. Rritet edhe numri i punonjësve, ne do të ndërtojmë edhe atë që ne duhet ta bënim fakt, sivjet, por që GIZ nuk mbaroi projektin. Fusha e ndarjes në burim të mbetjeve është një ndër investimet më të rëndësishme, të dyja bashkë. Një fushatë shumë të fortë sensibilizuese ne do e fillojmë diku në shkurt, do përgatitemi të gjithë. Besoj se do marrim pjesë të gjithë sa jemi këtu, edhe këshilltarë, dhe në fund të fundit është një histori e cila është e financuar edhe në vlerë monetare, por edhe e orientuar për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe të turizmit në këtë zonë. Pra, jemi duke e parë me shumë kujdes. Do vazhdojmë të blejmë prapë mjete për bujqësinë. Ndërsa këto ditë pritet të na vijë eskavatori i madh. Do vazhdojmë më tej, do marrim fadromë, do vazhdojmë prapë me blerje, pra çdo ditë për ta fokusuar gjithmonë vëmendjen edhe tek bujqësia. Ato që ne i kemi prioritet janë: çfarë ndodh me këto? Me këto ndodh, për shembull, që në rrugët e bregdetit, pothuajse gjithë fshatrat që aksesojnë bregdetin mbyllet një histori. Na ngelet ndonjë gjë, por jo gjëra kryesore, pra rrugët kryesore që aksesojnë të gjitha hyrjet e daljet në bregdet e të fshatrave përreth, duke e lidhur edhe me prodhimin që mund të shitet apo të sidomos po marrim zonën e bregut të Matës, që e ka më afër, po pse jo edhe Zejmenin, e të gjithë, kanë mundësi që të lidhen në mënyrë më të lehtë me gjithë vijën bregdetare. Kjo ka qenë një fokus i yni, që do e trajtojmë bashkë me qeverinë. Atëherë, nga Zejmeni deri në Krajën, ne vazhdojmë bllok me një paketë mbi rreth 12 miliardë, ku ne shkojmë në dy vjet financim, duke pasur parasysh se në kuptimin e të ardhurave bashkia është në ditë të mira, viti që vjen do të jetë edhe më i mirë. Pavarësisht se ne kemi planizuar nën atë që mendojmë, por unë mendoj që viti tjetër do të jetë akoma më i fortë, për arsye të infrastrukturës e cila ndërron edhe marsh, pasi referencat do jenë shumë më të larta sesa janë tani. Domethënë, në kuptimin e pagesës do kemi shumë më tepër, plus pastaj edhe administrimi i jonë, i cili ka qenë, mendoj, shumë korrekt. Ne, 59% të buxhetit tonë, me lekët tona e çojmë tek investimet. Pra, jemi fokusuar kryesisht tek investimet dhe mendoj se nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë buxhet tjetër që është fokusuar në këtë drejtim, duke e vlerësuar realisht një situatë të cilës ne duhet t'i japim fund. Ndërkohë që kemi edhe pjesën e Dajçit. Kemi disa rrugë që do bëjmë atje, por shumë rrugë janë bërë. Kemi projektin e ujësjellësit të madh

Dragushë. Mbarojmë stacionin e pompimit të ujitjes për në Dragushë, fillojmë në Grash, pra fillojmë edhe me ujitjen. Përveç kanaleve kulluese që ne do vazhdojmë me intensitet, vazhdojmë edhe në sistemin e ujitjes, bëjmë dy stacione pompimi. Do e mbarojmë nga pranvera, tjetrin do ta fillojmë. Mendoj se janë dhe disa rrugë të tjera që nuk çenojnë linjat e ujësjellësit, por që ne hyjmë dhe e trajtojmë, pra aty në Dajç po bëhet dhe ujësjellësi, mos të harrojmë se e kemi në proces tashmë, në Rraboshtë po bëhet ujësjellësi, dhe si problem, jemi fokusuar nga Kallmeti, pra aty kudo, po ta shikosh, ka një, dy, tre punë janë duke u bërë, jo një, po disa punë. Dhe fakti që janë disa punë tregon se i kemi marrë gjërat me radhë. Ka plot njerëz që thonë: jo po hidhi ti ca zhavor, jo po hidhi ca kështu... Ne nuk duhet të bëjmë punë më, që sot e bëjmë, nesër e shkelim, kështu ndodhi në Gocaj. Do të ndërtohet lagjja Nënë Tereza, nuk mjaftohet vetëm me rrugë, do të ndërtohet komplet pjesa. Pra, do të rikualifikohet, aty ku është sot kënetat, aty ku është Casa Ola, ne do ta bëjmë zonë atraktive, pra do të financohet komplet transformimi i asaj zone. Jemi në diskutim aty që të bëjmë dhe dy pallate me Entin e Banesave, ku ata do hyjnë edhe me parking nëntokësor që i ofrojmë edhe parkingun, dhe gjithë zona tjetër do jetë me pedonale që vjen rrotull, me kënde lojrash për fëmijë dhe me zona atraktive. Është ndërtimi i pedonale që e kemi, që ta dini, në qytet. Do të ndërtojmë një pedonale nga sheshi te Milenium, te Papa Gjon Pali, deri tek xhamia, një pedonale, rrugë e cila në darkë do bllokohet me sistem dhe aty do jetë e konfiguruar me disa kioska si tip rrugë, edhe tregtare, ku edhe rrihet në darkë, edhe argëtohet, edhe shitet, edhe bëhet një jetë dinamike në darkë. Duke i shtuar këtu, mendoj se faza e parë e Fondit të Zhvillimit ka kaluar parkingun nëntokësor. Ne mendojmë se brenda vitit fillojmë me parking nëntokësor dhe ndërkohë i shoqërojmë pastaj me fondin e zhvillimit me gjithë rikualifikimin e një parku të madh. Nuk ka pallat aty, do ketë park, një park kreativ ku të dalin të gjithë banorët. Besoj se ne, brenda marsit do ta kemi, sepse ka kaluar faza e miratimit të parë dhe besoj se do shkojë drejt financimit. Është duke u financuar plani i transportit urban. Ne do bëjmë një plan dhe sat ë jetë gati, ne me vendim këshilli do japim konkurimin për linja. Linjat do konkurohen me standarde, jo më kështu: merr e bëj çfarë të duash me lloj-lloj mjetesh aty. Mjetet do jenë bashkëkohore, do të ndërtojmë një sistem, por do të kemi një plan. Një plan që do të bëhet me studim të hollësishëm që mos të gabojmë dhe të ndërtojmë të njëjtën gjë, të njëjtën histori sikur kemi sot. Do të ndërtojmë një urë këmbësore në kanalën e Shtrausit, i cili siç keni parë është duke u trajtuar. Kemi rënë dakord me Ministrinë e Bujqësisë që të marrim edhe një financim tjetër, ta ngrejmë kanalën deri në Grykë Manati, me veshje, me të gjitha, që ta disiplinojmë, duke pasur parasysh se ajo është një pjesë e rrezikshme, jo vetëm sepse është e rrezikshme se del nga shtrati ndonjëherë, por është një histori që lidhet edhe me një sjellje të shëmtuar të banorëve aty te rruga Shtraus, që hedhin plehra prej ballkoni po ne do t'i blindojmë me kamerat ose s'ka rrugë tjetër, kush guxon me i nxjerrë prej dritare aty, pastaj do ia çojmë te shtëpia ose do ta penalizojmë, sepse do të jetë në sistemin e një kontrolli të imtësishëm. Është prokuruar, fillon financimi i varrezave. Është mbyllur kontrata, është bërë një ankesë, të mbarojë ankesa ndaj Bashkisë, dhe do vazhdohet, kështu që edhe varrezat e qytetit janë adresuar.

Pra, pak a shumë, këto janë shtyllat kryesore ku buxheti shprehet në kuptimin e investimeve.

Pastaj do të komunikojmë me Ministrinë e Arsimit, edhe me projektet e tjera, nëpërmjet emergjencave, do të adresojmë edhe disa problematika që kanë të bëjnë me shkollat.

Me Federatën e Futbollit kemi një dakordësi që mund të bëjmë të paktën tre fusha, mund të bëjmë Torovicën, Dajçin dhe Zejmenin, tre fusha të mira sportive. Duhet të ulemi të

dakordësohemi, por në parim, kemi thënë po, kemi thënë po në parim edhe për stadiumin, po biem dakord.

Duhet të keni parasysh një gjë: interesi i investitorëve, edhe shqiptarë, në Lezhë është në nivelet më të larta historike. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që të ketë një interes kaq të lartë. Zamir Mane ka marrë lejen, e zbardh këto ditë për 60 mijë m² në Tale, vazhdon investimi mbropa, vazhdojnë disa resorte nga më të mirat, nga arkitektët më të mirë. Normalisht kjo përkthehet edhe në të ardhura. Duke u përkthyer në të ardhura, përkthehet edhe në investime, dhe ne kemi përse besojmë se jemi në trajektoren e duhur për të arritur.

Në një hark kohor prej tre vjetësh, që prej sot ne do të kemi harruar historinë e rrugëve me baltë, të rrugëve me gropa, prandaj mendoj se ka ardhur koha që ne të bëjmë realisht një punë të organizuar. Është një grup djemsh nga Gocaj të cilët kanë një biznes shumë të fortë në Amerikë dhe kanë shprehur interes për një park shumë të madh aktualand, një nga më të mëdhenjtë në Ballkan. Kanë ardhur dhe kanë diskutuar me mua. Aty do bëhet një ndër qendrat më të bukura të rajonit. I kam takuar edhe në Amerikë, i kam takuar dhe këtu. Pra janë duke u adresuar disa gjëra që ka mundësi shumë shpejt të biem dakord me një projekt që kemi bërë ne: pallatin e sportit dhe terminalin e autobusëve dhe parkingun nëntokësor ta bëjmë te depozitat ku janë aty te ANTAG-u, ta bëjmë një ndërthurje të investimit të qeverisë me investimin e bashkisë dhe të privatit. Jemi duke u konsultuar, jemi në dakordësi me disa kompani edhe nga jashtë, shqiptarët që punojnë jashtë. Janë një grup në Londër që kanë potencial, janë edhe këto djemtë nga Gocaj që kanë interes. Ka dhe të tjerë, jemi duke iu bashkangjitur edhe kësaj që thamë, pra marrëdhënies me biznesin privat, për ta tërhequr, sidomos djemtë që janë nga Lezha dhe kanë potencial, që t'i sjellim këtu, t'i krijojmë gjithë fasilitetet e nevojshme, që ato të ndjehen mirë edhe të investojnë. Dua të them hapur këtu në Këshillin Bashkiak, kushdo që ka një njeri që do të investojë në Lezhë, në Shëngjin, në cilëndo pikë, as nuk do ta mendojë se në procesin e dhënies së lejes apo marrëdhënies me bashkinë mund të paguajë një lek. Zero! Kurrë s'ka ndodhur, as nuk ka për të ndodhur për askënd që vjen. Unë i kam garantuar të gjithë, do vish, po hajde, e ke zero, as mos e mendo, sepse është psikoza që prodhojmë ne përditë nëpër Facebook. As nuk hyjmë e as nuk merremi. Kush vjen e investon në Lezhë, që nga një lek deri me miliarda lekë, e ka zero marrëdhënien me ne. Kështu që inkurajojini të vijnë. Një garanci që jua jap unë është kjo: hajdeni. E kemi dakordësuar me kryeministrin dhe me një ndër kompanitë më të forta italiane dhe një grup që ka marinat e Venecias që janë në kombinim me atë kompani, e kemi takuar, kemi diskutuar mbi një projekt ide që kishin ata, janë bërë vërejtjet përkatëse. Kemi qenë në 25 nëntor, ne kemi qenë te kryeministri në diskutim për portin e Shëngjinit. Mendoj se është dakordësuar, kanë ardhur, kanë parë, një herë, dy herë, kanë dhënë një projekt shumë ambicioz. Nëse bëhet ajo, që unë mendoj se po, domethënë, ata kanë pajtuar dhe studion që të përgatisë dokumentacionin. Unë mendoj se kemi vënë në rrugën e zgjidhjes edhe problemin e portit, që i jep një tjetër histori Shëngjinit bashkë me Bypass-in, bashkë me Milot-Balldrenin.

Thashë, ne në tre vjet do të jemi në një tjetër stad të jetës në Lezhë dhe do jemi, nuk diskutohet fare kjo, nuk diskutohet. Unë mendoj se gjithsecili prej jush duhet ta shikojë pozitivisht tendencën e zhvillimit, sepse janë disa gjëra me të cilat ne përballemi çdo ditë. Ka dhe një problem tjetër; duhet të ndërjegjësohen njerëzit t'i paguajnë kontributet. Jo se ato kontributet e tyre e bëjnë rrugën, por ato kontributet e tyre tregojnë se këto janë taksat tuaja që kanë pjesën e vet. Tashi të dalin ca njerëz aty dhe të rrinë duke vjedhur nëpër Facebook, e në fakt s'kanë paguar në jetën e vet një lek taksë, mua më duket si absurde. Mund të bërtasësh, po bërtit kur ke

paguar diçka; kur s'ke paguar, s'ke pse bërtet. Kështu që marrëdhënia me bashkinë: ne jemi administratorë të taksave të banorëve, ne nuk jemi shpikës lekësh, as prodhues lekësh; ne mbledhim taksat dhe ne nuk do hyjmë në detaje, kush do me ditë pastaj, ne këtu i kemi shifrat, jemi me tre herë më shumë. Është normale kjo. Domethënë, vitin tjetër do jemi edhe më shumë, pa diskutim. Të paktën katër resorte të mëdha janë që do paguajnë taksën e infrastrukturës, ai ka 45 milionë euro të paktën. Kështu që nuk kemi frikë më nga problemet financiare. Problemi është që t'i administrojmë këto lekë dhe t'i çojmë në drejtimin e duhur. Tani, unë në vija të trasha, kaq kisha. Edhe te kultura do them dy fjalë. Kemi ndërhyrë, është bërë Muzeu Arkeologjik, tani kemi dhe programe të ReLoad, ku kemi vënë rreth 40 milionë të vjetra, për programe të ndryshme që stimulojnë rininë, që stimulojnë organizata të ndryshme të shoqërisë civile, që na sjellin projekte dhe ne shpallim fitues për t'i implementuar dhe i japim mundësi. Janë edhe 20 milionë për projekte artistike, është ajo që ne kemi filluar duke e bërë tashmë sepse njëri vjen në mars, tjetri vjen në prill, jo mua më duhen lekë, mua më duhen lekë... Kush i thotë këtyre njerëzve se i kemi lekët kështu nga ato që futen në thes. Jo, po ti ke... Ku i kam? Duhet me ardhë këtu në këshill, me u marrë vesh... Atëherë, ne do shpallim thirrjet nga 1 milion të vjetra deri në 3-4 milionë. 70% të fituesve do të jenë nga Lezha. Do stimulojmë të gjitha grupet artistike, organizimet, programet, projektet që kanë të rinjtë, të rejtat, grupet e Lezhës, duke i dhënë fokus më shumë kësaj, ndërsa 30% mund të vijnë edhe të tjerët. Tani kush ka ndonjë gjë... edhe drejtorat mund të flasin.

-Ndue Luli: Faleminderit.

Fjalën ka kryetari i Komisionit të Financave për disa sqarime në lidhje me projektbuxhetin. Pastaj do kalojmë te pyetjet.

-Agostin Marku: Faleminderit. Programi buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxheti vjetor 2026 kanë kaluar të gjitha fazat e vendimmarrjes përgjatë gjithë këtij viti, por edhe dëgjesat publike, pra ka ndjekur gjithë rrugën ligjore dhe kemi ardhur sot në miratimin përfundimtar të këtij programi, që i takon edhe ushtrimin e vitit buxhetor të 2026. Është shumë e rëndësishme që kjo shifër rekord e buxhetit që është 26 miliardë lekë ose 26 milionë euro, peshën kryesore e zënë të ardhurat e veta ose ato që e quajmë shpesh nga grumbullimi i taksave dhe tarifave vendore, dhe kjo shumë është mbi 60% e buxhetit total që ka Bashkia e Lezhës në dispozicion, çka flet se aftësia menaxheriale e aparatit administrativ, e drejtuesit të bashkisë është duke u konsoliduar gjithnjë e më shumë. Kjo flet për një garanci që edhe në të ardhmen, investimet do të jenë akoma më të mëdha dhe më të konsoliduara në shërbim të qytetarëve të Lezhës. Është fakt pozitiv gjithashtu që të gjithë programet buxhetore, që janë tetë programe buxhetore, janë të përfshira, janë të plotësuara sipas kërkesave që kanë bërë drejtoritë përkatëse. Vlen të përmendet që programi buxhetor, infrastruktura, mjedisi, dhe shërbimet publike është zëri më i fuqishëm i programit buxhetor, çka tregon që vëmendja e bashkisë është pikërisht këtu, tek infrastruktura, mjedisi, shërbimet publike, që janë edhe më sensibil edhe për qytetarët. Gjithashtu vlen të theksohet që në strukturën buxhetore të programit buxhetor 2026, shifrat dhe raporti i ndarjes shkon në favor të investimeve publike, gjë e cila, në shumicën e rasteve në njësitë vendore, është një tregues që fut vetë institucionet buxhetore në ngërç duke u përqendruar në fakt te shpenzimet tek administrata, tek shpenzimet e tjera operative. Por këtu ne kemi një rritje të konsiderueshme të investimeve. Tani, i gjithë ky volum pune, e gjithë kjo shifër e lartë, të gjitha këto, pra edhe raporti të ardhurat e veta me grantet, me buxhetet e kushtëzuara, të pakushtëzuara e të tjera e të tjera që jep qeveria, që japin fondacione të ndryshme, pra ka rritje kjo pjesë e bashkisë. Vlen të

përmendet se struktura organike e bashkisë nuk lëviz, pra nuk ka rritje, po përballohet gjithë ky volum pune me këtë administratë që kemi aktualisht, pra që tregon se shpenzimet administrative janë të mirëkontrolluara nga bashkia. E gjitha kjo bën atë që kemi të bëjmë me një punë shumë serioze, por që duhet të vazhdojë në të ardhmen, që të konsiderohen të ardhurat, të mbliidhen më shumë, të kemi efektivitet më të lartë në grumbullimin e të ardhurave, sepse kërkesat janë gjithnjë në rritje. Edhe në diskutimet nëpër komisione, shumë këshilltarë kanë diskutuar dhe me të drejtë kanë kërkuar, pse kjo, pse mos të jetë edhe kjo e të tjera, dhe po të pyesim sot kryetarin e bashkisë që thotë që kemi një buxhet goxha të madh, që është e vërtetë. Po ta pyesim kryetarin e bashkisë, thotë: “Të kemi lekë prapë, unë do t’i bëj dhe 100 objekte të tjera, pse, se duhen”. Por është fare e arsyeshme që janë më emergjentet, më kryesoret, më efektivet për t’i konsoliduar, dhe kemi të bëjmë me një konsolidim të jashtëzakonshëm të infrastrukturës, shërbimeve publike, pse jo edhe investimet, rikonstruksionet e ndryshme dhe në shkolla, në kopshte, çerdhe e të tjera. Unë do t’i sugjeroja bashkisë edhe në ato propozime që sot mund të kenë këshilltarët, por edhe grupet e interesit, por edhe vetë drejtoritë, të mbahen në konsideratë, sepse ne më përpara do kemi edhe një ndryshim buxheti shumë të shpejtë në muajin mars, që vjen si rezultat i rakordimeve buxhetore të fundvitit dhe të përfshihen në atë paketë që do kemi me ndryshimet e muajit mars. Aktualisht, deri në këto momente ka propozime, ka sugjerime, por në asnjë rast nuk kemi një propozim në formën e amendamenteve, që do të thotë për ndryshime buxhetore. Unë do t’ju rekomandoja që këshilli ta miratojë këtë buxhet dhe urojmë që do të ketë zbatim konkret për 2026-ën, duke sjellë një konsolidim të jashtëzakonshëm të infrastrukturës në territorin e Bashkisë Lezhë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Pyetje? Zoti Jaku.

-Marko Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Në buxhetin e 2026, në njësinë Shënkoll nuk preket, vetëm nga qeveria. Sa rrugë do të bëhen në njësinë Shënkoll, në Barbullojë? Rruga Bakaj a është?

-Pjerin Ndreu: Implementohet paketa më të mëdha, siç shpjegova më përpara. Ne kemi rënë dakord me qeverinë që do bëhen të gjitha. Të gjitha rrugët e fshatrave: Shënkoll, Rrilë, Tale 1, Tale 2, Grykë Lumi. Nuk flasim me rrugë nominale ne.

-Marko Jaku: Unë shikoj të gjitha rrugët e zonës, Barbullojë, Rrilë, edhe komplet njësia e Shënkollit, që t’i dimë se cila e cila dhe kur.

-Pjerin Ndreu: Tashi nuk do jenë 100% rrugët. Do jenë rrugët më të domosdoshme, do jenë mbi 70% të rrugëve. Se në qoftë se doni me bë 100% të rrugëve sivjet, më vjen keq, po është e pamundur. Ne do bëjmë sasinë më të madhe të rrugëve, dhe nëse ka njësi që s’mund të qahet fare, është njësia Shënkoll. Nuk keni pse qaheni fare, se aty është punuar gjatë gjithë kohës. Po bëhen vetëm...

-Marko Jaku: Sa të punosh, ka kërkesa.

-Pjerin Ndreu: Vetëm në Rrilë po bëhet autostradë-Rrilë-Hidrovor, s’e keni parë as në ëndërr! “U bë rruga nga Myltja në Grykë Lumi që s’e keni menduar as në ëndrrat më të gjata të dimrit, as qendrën e Rrilës, as kanalet kulluese që i kemi bërë të gjithë, dhe ju kanë shpëtuar kësaj radhe nga gjithë ai kiamet pa u mbyt në ujë, se kemi qenë ne që i kemi parapri situatës, e të tjera. Kështu që nuk ju ka harruar kush.

-Ndue Luli: Zonja Prendaj.

-Rajmonda Prendaj: Përshëndetje të gjithëve. Besoj se të gjithë biem dakord se në Njësinë Zejmen, kryesisht në fshatin Zejmen dhe jo vetëm, është punuar shumë mirë me rrugë, kanalizime, ujësjellësa, mirëmbajtje të rrugëve, pastrime e të gjitha. Ashtu si besojmë se do të punohet akoma më shumë, dhe do të realizohen të gjitha projektet që janë parashikuar, por duke parë se janë parashikuar disa rrugë në njësinë Zejmen dhe meqenëse rruga e varrezave në fshatin Zejmen që i përket malit Zejmen, nuk është parashikuar këtë radhë, ndaj kërkoj që në rishikimin e buxhetit në mars të merret në konsideratë dhe të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur, pasi pjesa e rrugës ku është me çakull, nga shirat e kohëve të fundit është dëmtuar dhe del jashtë përdorimit.

-Pjerin Ndreu: Në atë rrugë ne kemi bërë ndërhyrje, e kemi sjellë në kondicione normale. Normalisht që mund të ketë dëmtime që mund të ndërhyjmë prapë, është 2 km në rrugë. Në qoftë se Zejmeni, banorët firmosin që të lemë rrugë poshtë e të bëjmë rrugën e varrezave, për momentin nuk e shohim alarmante situatën për të shkuar me asfalt në varreza. Nesër po, mund të jetë, por jo në këtë buxhet që sjellim sot.

-Rajmonda Prendaj: Unë ndaj e ceka që mendoj që në rishikimin e buxhetit të konsiderohet.

-Pjerin Ndreu: Janë, janë në rishikimin e buxhetit, janë dy rrugë që i kemi lëviz, që do vihen. Janë në Tresh dhe në Gajush që do bihen, pra e kemi lënë me marrëveshjen, mbasi i kemi parë për mos ta lënë Ungrej, dhe do bëjmë. Pastaj do hyjmë në zonën e Gocaj-Kakarriq, për arsye të kësaj dileme që kemi me ujësjellësin, prandaj jemi tkurr pak. Të parët do hyjmë në Balldren, kryesisht.

-Ndue Luli: Faleminderit.

-Rajmonda Prendaj: edhe diçka tjetër, të lutem.

-Ndue Luli: Pyetje? Vazhdo.

-Rajmonda Prendaj: Ajo që dua të them është në lidhje me përmbytjet e kohës së fundit. E dimë të gjithë se fatkeqësitë natyrore nuk është se mund t'i shmangim, nuk janë në dorën tone, këto probleme ndodhin edhe në shtetet më të mëdha se ne. Vështirë t'i përballojmë, por pas së gjithash, tani mendoj se duhet një zgjidhje e shpejtë për fermerët dhe duhet të bëhet e mundur një formë kompensimi për dëmet e shkaktuara. Kaq kisha. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Jemi duke u marrë me këtë gjë.

-Ndue Luli: Fjalën ka për pyetje zoti Marku.

-Rrok Marku: A ka project që shëtitorja të vazhdojë deri sipër urës së re që është bërë?

-Pjerin Ndreu: Jo. Nuk ka.

-Rrok Marku: A parashikohet që mund të bëhet?

-Pjerin Ndreu: Ka projekt për ta çuar nga Ishulli në det. Na është premtuar financim, po meqenëse do hyjmë në rrugë, nuk mund të premtojmë për sivjet. Projekti është për ta çuar në det shëtitoren. Këtej sipër akoma s'kemi ndonjë projekt.

-Rrok Marku: Na është premtuar që do të hyjë Fondi Shqiptar i Zhvillimit për ndriçimin e fshatrave.

-Pjerin Ndreu: Kemi dy projekte: kemi ProLight-in që e kemi fituar dhe do ta fillojmë implementimin tani, për ndriçim në zonat rurale, kemi dhe aplikimet në Fondin Shqiptar të Zhvillimit që do i alternojmë të dyja bashkë dhe besoj se do bëjmë shumë punë me ndriçimin.

-Rrok Marku: Para një jave afërsisht bëmë një takim me të rinjtë e gjimnazit këtu në këshill dhe ata bënë një pyetje: Si kualifikohen rrugët e qytetit të Lezhës? A mendohet se mund të ketë një korsi për biçikletat?

-Pjerin Ndreu: Për momentin jo. Ajo do të shikohet pasi të bëhet parkingu nëntokësor, për arsye se do hiqen të gjitha parkingjet pastaj në rrugë kryesore. Lezha është bërë me rrugë të ngushta, fatkeqësisht, që nuk i përgjigjen rritjes së popullsisë, bumin të popullsisë që është sot. Atëherë, ne vetëm parkingjet tokësore do na krijojnë mundësinë që të mendojmë për një fazë tjetër që është me korsi biçikletash.

-Rrok Marku: Na është thënë në takim që bëmë në Zadrinë se do të kemi informacion se do të vihet dorë në fiderat e Kallmetit e Zejmenit në përmirësim të furnizimit me energji elektrike.

-Pjerin Ndreu: Këto nuk janë punët e buxhetit, por janë negociata që ne jemi duke u marrë. Dhe unë e di se është adresuar ajo pjesa aty për shkak të agroturizmeve e zhvillimit. Me çfarë di unë, është futur projekti në financim, po kjo s'është çështje e jona e këtij buxheti.

-Rrok Marku: Thashë për informacion. Ju falenderoj që administrata ka planifikuar 21 rrugë në njësinë administrative Blinisht.

Edhe që të ketë një farë proporcionaliteti, mendohet se mund të ketë në mars edhe tre rrugë, dy në Baqel edhe një në Piraj, që të ketë një shpërndarje kështu, pak më proporcionale.

-Pjerin Ndreu: Qartësisht, ju sqarova. Janë dy rrugë në Zejmen që do t'i risjellim në mars dhe është njësia e Balldrenit. Pra, ju thashë se çfarë ngërçi kemi në Ballden, pra a do vijë ai grupi këtej nga Torovica me e marrë seriozisht këtë punë, që do vijnë mbas janarit. Kanë konfirmuar që do vijnë dhe ne do shkojmë në terren. A do lejë hapësirën Gocaj-Kakarriq se Balldreni Kodër i ka të gjitha rrugët të bëra. Në Balldre Fushë kemi edhe një problem tjetër që lidhet me nyjen e autostradës që nuk është zgjidh, dalja nga tuneli i nyjes që do bëhet, se do bëhet një nyje që hyn në Torovicë e hyn këtej aty dhe akoma nuk është zgjidh tamam-tamam, që jemi pak si në dilemë aty, pra ka një konjunkturë zhvillimi e cila na lë ne pak kohë për të parë se si do hyjmë. Pastaj do shikojmë se si do të qasemi me atë që thamë, me një ofertë e cila është në diskutim.

-Ndue Luli: Ka shumë këshilltarë që duan të flasin. Të gjithë do bëni pyetje, pa merak.

Fjalën e ka zonja Sokolaj, pastaj zonja Marku.

-Regjina Sokolaj: Faleminderit kryetar. I nderuar kryetar i bashkisë, të nderuar kolegë, anëtarë të këshillit bashkiak, të nderuar përfaqësues të administratës së bashkisë. Sot po shqyrtojmë programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026.

-Ndue Luli: Më fal, zonja Sokolaj, a kishe pyetje apo diskutim?

-Regjina Sokolaj: Po thashë ta ezauroj.

-Ndue Luli: Faktikisht është mirë që pyetjet t'i mbarojmë, më fal shumë që po të ndërpres.

-Regjina Sokolaj: S'ka problem. Atëherë, pas një analize të kujdesshme, besoj se programi buxhetor afatmesëm 2026-2028 paraqet një vizion të qartë, realist dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e bashkisë sonë. Ai garanton vazhdimësinë e investimeve në sektorë kyç si infrastruktura, arsimi, bujqësia, kultura, mjedisi, shërbimet publike. Duke u mbështetur në nevoja reale dhe prioritete të identifikuara qartë. Pamë se janë planifikuar në buxhet në fushën e arsimit investime për rikonstruksionin e shkollës nëntëvjeçare "Gjatë Fishta", rikonstruksionin e kopshtit "11 Janari". Unë dua të shtroj dy problematika që kanë të bëjnë me qytetin e Shëngjinit. Në qytetin e Shëngjinit ka një shkollë model, një kopësht shumë të mirë dhe me kushte optimale, por është nevojshme dhe domosdoshmëri të ketë një çerdhe për fëmijët deri në tre vjeç, pasi kjo do të ishte një ndihmë e madhe për nënat e reja dhe natyrisht do të ndihmonte rritjen e mirëqenies familjare duke mundësuar që të dy prindërit të punojnë. A ka një projekt lidhur me këtë çështje? Gjithashtu, këtu do të shtoja se kontributi në të ardhurat e bashkisë nga qyteti i Shëngjinit dihet që është shumë i madh, pse janë planifikuar pak investime në rrugë për qytetin e Shëngjinit? Këto dy pyetje kisha.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, në njësinë Shëngjin hyjmë në sistem me qeverinë, dy Ishujt, rrugët e dy Ishujve. E dyta, tani që flasim është bypass-i i Shëngjinit. Jua kam thënë edhe në një mbledhje tjetër këshilli, mendoj se do ketë një tjetër histori që lidhet me impiantin e ujërave të zeza i cili do të dyfishohet kapaciteti me një financim që është aplikuar nga KFË, dhe mendoj se do ketë një tjetër qasje. Në këtë problem, ne jemi duke testuar ujësjellësin. Sivjet do të ulemi me KFË-në dhe ne pretendojmë; të paktën, propozimi ynë është që të hyjmë në sistemin e shpërndarjes, të rikuperojmë sistemin e shpërndarjes, sepse sado që e ka mbuluar me ujë, nuk është sistemi i shpërndarjes, i cili i ka shërbyer të gjithë zonat e Shëngjinit. Duke qenë se jemi në sistemin e shpërndarjes, ne jemi kufizuar për të hyrë, për t'i bërë të gjitha rrugët. Ndoshta buxhetin e vitit tjetër ne do planifikojmë që të hyjmë. Ndërkohë kemi një problem shumë më madhor se kaq, me 2.7 milionë euro që i kemi planifikuar dhe presim t'i marrim financim nga qeveria, ne duhet të eliminojmë komplet ujin në rrugët e Shëngjinit, rrugët ku uji bëhet si det aty dhe ne nuk dimë se kur janë bërë ato rrugë. Nuk ka pyetur kush për të bërë kanalizim. Tani detyrohemi ne, siç bëmë te NET Center që "jo bëhet, jo s'bëhet, jo shkon, jo s'shkon, jo niveli, s'niveli". Në fund s'ka pike uji! Pra, në Shëngjin ne do të heqim ujin patjetër dhe e kemi bërë planifikimin, pra do t'i bëjmë me radhë gjërat; Shëngjini e ka domosdoshmëri dhe ne do ta adresojmë atë problematikë patjetër. Sivjet ne rakordojmë me KFË-në, do hyjmë, edhe është një plan për 4 miliardë për të hyrë në sistemin e shpërndarjes për ta shtuar historinë e investimit atje. Atëherë do ishte më e mira e mundshme që mund të bëjmë ne, se ndërkohë që hyjnë ata, ne mund të hyjmë edhe me eliminimin e këtyre që thamë. Prandaj është e njëjta situatë sikur ka ndodhur në qytet, sepse domethënë tendenca për të bërë infrastrukturë dhe në fakt ti s'ke bërë asgjë sepse nuk ke trajtuar problemin poshtë, të gjithë linjave poshtë ku ne bashkë me ujësjellësat edhe me këto, ne duhet të adresojmë edhe futjen e kablllove poshtë. Pra të gjitha linjat e internetit nuk do lejohen më në ajër. Dhe ne duhet ta çlirojmë qytetin, por t'i bëjmë tamam siç duhet, jo t'i bëjmë siç s'duhet, sepse nuk është një problem shumë i madh nga ana buxhetore të hysh në Shëngjin, tashi t'i shtrosh rrugët, mirëpo mbas një viti del historia e sistemit të kanaleve për ujësjellësin. Ne s'kemi zgjidhur akoma problemin përfundimisht të ujësjellësit aty, që Shëngjini nuk duhet të ketë më, ajo linja që ka vënë KFË ka shmangur 50% humbjet për arsye se tubi është i atij lloji ku s'ka shans të ndërhyjë kush, sepse ka pasë ndërhyrje te uji i bashkisë, nuk mundet, ka zero shans. Duke pasur zero shans, nuk ka bërë kush as aty te ANTAG-u as andej rrotull

për ujë. Sivjet ka qenë e mbuluar, por ka pasur tek tuk ndonjë oshilacion që na lë ne të mendojmë dhe ishte test që ne duhet të hyjmë më tej dhe duhet ta zhvillojmë këtë histori, se nuk mund ta lëmë ashtu, aq më tepër që është zonë turistike.

-Ndue Luli: Faleminderit, fjalën ka zonja Marku, përgatitet zoti Gjinkola.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Siç u tha deri tani, kjo është mbledhja më e rëndësishme, patjetër, sepse diskutohet dhe përcaktohet destinacioni i taksave dhe tarifave që gjithë banorët e dhjetë njësive administrative të Lezhës i paguajnë në mirëbesim, në mënyrë paraprake, me kushtin që të marrin shërbime të përmirësuara dhe investime të reja në këmbim. Kuptohet që ju flisni që ky është buxheti më i lartë i këtyre viteve, por pa diskutim që sa më i lartë është buxheti, aq më e madhe është përgjegjësia për një ndarje të drejtë dhe të arsyeshme të tij, dhe aq më e madhe është përgjegjësia për një zbatim në kohë të investimeve të planifikuara dhe, kuptohet, cilësinë dhe standardet e duhura. Unë do ndalem në dy argumente, u tha edhe...

-Ndue Luli: Zonja Marku, Të lutem. Më fal, a ke pyetje?

-Alfrida Marku: Po, i kam pyetje të argumentuara.

-Ndue Luli: Bëj pyetjet që të marrim përgjigjet, pastaj argumentet na i jep në diskutim, më mirëkupto.

-Alfrida Marku: Siç ju dëgjuam ne ju, kuptohet, ju do të keni durim të na dëgjoni.

-Ndue Luli: Patjetër shumë, biles pa merak. Por bëj pyetjet dhe pastaj, kur të marrësh fjalën në diskutim, mund të japësh argumentet e tua si të duash ti.

-Alfrida Marku: Unë besoj e ke kuptuar që mënyrën se si flas edhe se çfarë them.

-Ndue Luli: Të gjithë të kuptojmë, të gjithë që jemi këtu të kuptojmë. Prandaj zbatoje këtë që po të them, se është në të mirën e përbashkët.

-Alfrida Marku: Nuk ka ndodhur ndonjëherë që të më imponojnë se si të flas, kështu që ki durimin më dëgjo deri në fund.

-Ndue Luli: Jemi për pyetje zonja këshilltare.

-Alfrida Marku: E zgjedh unë mënyrën se si flasin në këshill, se kur jam votuar për në këshill nuk më kanë votuar, shkon në mbledhje të këshillit dhe bëj pyetje, shkon në mbledhje të këshillit dhe mbro interesin publik.

-Ndue Luli: Kemi miratuar një rregullore, zonja këshilltare. Rregullorja u miratua dhe me kartonin tënd. Të lutem. Jemi te pyetjet, bëj pyetjet, pastaj ke radhën e diskutimit kur të vijë radha.

-Alfrida Marku: Se është e kotë në fakt me vazhdu debatin.

-Ndue Luli: Jo e kotë, por është rregull, të lutem ta zbatojmë së bashku, edhe unë, edhe ju.

-Alfrida Marku: Po, sa mirë do ishte me filluar nga ju personalisht.

-Ndue Luli: Po patjetër, por i kam dhënë provat unë.

-Alfrida Marku: U tha dhe nga disa këshilltarë parafolës, nga një analizë dhe studim që kam bërë te plani i investimeve për vitin 2026, në listën e investimeve me një vlerë buxhetore rreth 9 miliardë, nuk ka asnjë investim për njësinë administrative të Balldrenit, të Ungrejt dhe të Shënkollit, që unë e konsideroj një ndarje jo të drejtë, jo të arsyeshme të buxhetit.

-Pjerin Ndreu: E sqaruam njëherë. Më duket abuzuese tani. Në qoftë se duhet t'i rikthehemi të njëjtit argument, po unë mendoj se, në qoftë se ne vëmë çështjen mbi çështje për me bë protagonizëm, është gabim, sepse nëse më thua: "Njësia e Shënkollit...", dhe ne në të njëjtën kohë kemi një program me qeverinë që është shumë i madh, dhe nëse thua ti "Balldeni", unë ta thashë Balldenin pse, do presim tepëricat për dy arsye dhe ta thashë pse dhe e sqarova në mënyrë shteruese. Çfarë duhet të filloj prapë ta sqaroj të njëjtën gjë? Nuk është mirë, se mbajmë këshillin kot, dhe Ungrej, nuk është me zero, Ungrej merr financim, dakord? Për mos me qenë me zero ne kemi bërë një lëvizje me Zejmenin që merr më shumë por që do të adresohen bashkë me Balldenin, Gocaj-Kakarriqi.

-Alfrida Marku: Jo, unë do të jap vetëm një argument...

Po s'është vetëm Gocaj-Kakarriqi!

Ju argumentuat që jeni në pritje të ndryshimeve buxhetore, që jeni në pritje të investimeve nga privati, thatë që jeni në pritje të miratimit të disa projekteve nga qeveria. Sot flasim për buxhet vendor, flasim për buxhetin e bashkisë. Kryetari i komisionit të financës sqaroi më përpara pse. Ta mbaroj argumentin...

-Pjerin Ndreu: Jo, jo, unë jam kryetar i Bashkisë së Lezhës dhe, duke qenë kryetar bashkie i Lezhës, kam përgjegjësi kur flas. Dhe në qoftë se unë kam adresuar diçka me qeverinë dhe e kam dakordësuar me të, ti nuk mund ta injorosh e ta shumëzosh me zero, as ti, as kërkush, sepse unë flas para njerëzve me përgjegjësi. Dhe në artikullimin tim publik, çfarë kam thënë, nuk e kam thënë kot kurrë. Kështu që ti nuk mund të lidhësh këshillin mbas një argumenti i cili është i sqaruar tashmë dhe në qoftë se ne do dublojmë njëri-tjetrin, do themi të njëjtën gjë që e thamë njëherë për këtë, do e themi prapë, për këtë do çohet njëri tjetër prapë, do thotë "po Shënkolli, po Balldreni", do vijë prapë tjetri, atëherë do rrijmë ne të riciklojmë të njëjtën përgjigje e të njëjtën pyetje. S'është korrekt edhe nuk mund të shumëzoni me zero atë, sepse ajo është, sa për dijeni, është projekti i bashkisë së Lezhës, dakordësuar me kryeministrin dhe nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit që implementohet në Lezhë. Se nga vjen burimi i lekëve, se nga s'vjen, në qeveri vjen, po me projektet tona. Edhe ujësjellësat vijnë me projektet tona, edhe rrugët e tjera që vijnë, që i bën fondi i zhvillimit, autostradë-Rrilë-hidrovor me projektin tonë është. I kemi prodhuar ne projektet, pa janë fituar financimet. Edhe shkolla "Gjergj Fishta", edhe këto janë projektet tona të bashkisë. Po mos të bënim ne projekte, s'kishin për të na dhënë asnjë lek kush.

-Ndue Luli: Po zonja Marku, vazhdo.

-Alfrida Marku: Unë mendoj që harta e investimeve duhet të prekte çdo njësi administrative. Pastaj, përzgjedhja e investimeve të duhura në secilën njësi administrative, duhet të bëhej sipas prioriteteve. Personalisht e konsideroj të paarsyeshme që një njësi si Balldreni të mos ketë investime, pavarësisht argumenteve tuaja. Ne flasim për buxhet vendor dhe u sqarua para këtij momenti që... në planifikimin e të ardhurave, 60% i përkasin të ardhurave të vetë bashkisë. Pra, 60% janë taksa të paguara dhe tarifa të paguara nga banorët e Lezhës. Nuk më duket e arsyeshme që një banor i Balldrenit të presë vitin tjetër buxhetor apo të presë ndryshime të ardhshme

buxhetore për investime të mundshme në zonën e tij. Shtuar këtu dhe faktin që, kur flasim për investime, nuk duhet t'i referohemi vetëm rrugëve. Kompetencat vendore kanë edhe shtrirje tjetër sa i përket menaxhimit të territorit edhe zhvillimit të vendit. Së dyti, absolutisht që i vlerësoj të gjitha investimet që keni planifikuar. Kuptohet, e theksoj sërish çështjen e prioritetëve. Një kolege këshilltare para pak minutash u ankua për një rrugë në njësinë e vet por në fakt unë dua t'i shtoj një argument, në 3,9 mld lekë investime në 9 njësitë administrative, përveç Lezhës, njësia që ju sapo përmendët zë 1.1 mld lekë.

--Ndërhyn kryetari i këshillit duke vënë theksin që të ezaurohen pyetjet

-Ndue Luli: Unë e quaj mungesë etike që të mos respektojmë rregulloren që e kemi miratuar vetë. Ne themi pyetje dhe kanë ngritur dorën 6 a 7 vetë që mund të kenë vetëm një fjali, një pyetje që kërkon një sqarim, dhe pasi bëhen pyetjet krejt mund të ezaurohen edhe nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve nga ana e kryetarit. Dhe kur të vijë puna për diskutim, dikush mund të marrë atë 10 minutëshin që i takon, dikush tjetër mund të marrë dy minuta, tre minuta. Pse? Se ezaurohen gjatë përgjigjes së pyetjeve. Pse nuk e zbatojmë një gjë të tillë? Të lutem, të lutem. Tani, pra, pyetja quhet pyetje, nuk ka hyrje as mbyllje, është pyetje. Vazhdojmë me pyetjen.

-Alfrida Marku: Çështja e dytë është: siç edhe thashë më përpara, i vlerësoj të gjitha investimet që keni parashikuar, por unë mendoj që është koha pra të shkojmë drejt një tjetër qasje sa i përket zhvillimit të Lezhës. E kam theksuar dhe në aktivitete të tjera: zonën urbane ne nuk duhet ta kufizojmë në atë ekzistuesen; pra, duhet të shkojmë te një qasje që ta zgjerojmë zonën urbane ashtu siç edhe zonat rurale nuk duhet të kufizohen vetëm te rrugët edhe kanalizimet e tokës bujqësore. Është shumë e rëndësishme zhvillimi i bujqësisë, por pa diskutim, kjo nuk mjafton për zhvillimin social të zonave.

Për të shkuar tek çështja e tretë dhe e fundit, që në fazën e parë kur diskutohej buxheti kam paraqitur zyrtarisht Bashkisë Lezhë disa propozime, disa problematika, disa projekte që personalisht, por edhe në komunikim me qytetarë, i kam konsideruar të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë në momentin e buxhetimit në këtë vit apo në dy vitet e tjera pasardhëse. Mendoj që ne duhet t'i kishim dhënë zgjidhje këtë vit buxhetor ndërtimit të çerdhes së re të qytetit të Lezhës dhe të qytetit të Shëngjinit, ashtu sikurse të gjenim përfundimisht një zgjidhje që kopshtet në njësitë e tjera administrative të kenë edhe shërbimin e drekës. Kam propozuar që në njësinë e Balldrenit, në fshatin Balldre i Vjetër, godina e vjetër e mbyllur e shkollës fillore të përshtatet si kopsht apo çerdhe. Pra, kam propozuar që ne, si këshill bashkiak dhe ju si bashki, të merrni një nismë për t'i hapur rrugë rikualifikimit të lagjes Skënderbeg dhe lagjes së Spitalit. Do na jepte mundësinë që të zgjerojmë zonën urbane, rrjedhimisht rikualifikimin e lagjes Skënderbeg dhe lagjes së Spitalit, po do ta sqaroj me cilat elemente. Do na jepte mundësinë që të identifikojmë hapësira të reja publike, do na jepte mundësinë që kur flasim për parking, që të mos kemi parking nëntokësor por parking të ri, do na jepte mundësinë që të kishim lulishte të reja. Do t'i zgjidhnim përfundimisht çështjen e ndotjes së qytetit nga fabrika në lagjen Skënderbeg, ashtu sikurse me një iniciativë shpronësimi apo lirimi të vërtetë të hapësirave, pra një iniciativë serioze të lirimit të hapësirave publike në lagjen e e Spitalit, do të kishim mundësi që t'i japim trajtë të plotë korpusit spitalor. Kam propozuar që është emergjente ndërtimi i godinës së re të qendrës së zhvillimit ditor. Gjithashtu, të kthejmë vëmendjen tek rikualifikimi i qendrave të njërive administrative, pse jo dhe biblioteka në ato qendra, në hapësira sportive, sepse në fshatra duhet të rikthejmë gjallërinë, sepse banorët po largohen. E kam shtruar si problematikë çështjen e erozionit në zonën bregdetare Kune dhe Vain, absolutisht është e

domosdoshme. Ne flasim për turizmin si shtyllë kryesore të ekonomisë, por kjo është një masë e domosdoshme që duhej ndërmarrë ndërkohë. Bashkia mund të pretendojë pamundësinë financiare, por mekanizmat ligjorë të qeverisjes na mundësojnë bashkëfinancimin me qeverinë. Është emergjente që qyteti i Lezhës të ketë një treg të ri industrial dhe ushqimor, ashtu sikurse të bëhet realitet një premtim i juaji që në buxhetin e vitit të kaluar për tregjet lëvizëse, në disa zona të Lezhës, kryesisht në Shëngjin, Shënkoll dhe Zadrimë. Së fundmi, mendoj që në një strukturë prej 867 punonjësish, është fakt që të gjithë këtu, të gjithë sa jemi këtu, e kemi pranuar, ne kemi punëtorët e shërbimeve, punonjësit e policisë bashkiake, edukatorët e çerdheve të keqpaguar. Pra, është fakt i pranuar edhe nga ju, edhe nga të gjithë këshilltarët. Duhet gjetur një mekanizëm, qoftë edhe lobimi nga ana juaj, me qëllim që edhe për këtë kategori të kemi pagesa dinjitoze që, për hir të vërtetës, aktualisht janë në kufij të pagës minimale. I kam propozuar gjitha këto pa diskutim duke e njohur realitetin këtu. Këtu vendimmarrjet bazohen në forcën e numrave, por gjithmonë unë besoj tek forca e fjalës edhe tek gjurmët e mira që gjithsecili kemi mundësi të lëmë. Dua që të shpreh vlerësim për mënyrën e re të menaxhimit të mbetjeve. Është një hap pozitiv që Bashkia e Lezhës e ndërmerr. Gjithmonë në fakt e kam besuar këtë, gjithmonë kam qenë e qartë që biznesi, operatorët privatë kur bëhet fjalë për pastrimin, më shumë e konsiderojnë si biznes sesa shërbim publik, ndërkohë që bashkia pa diskutim që ka detyrimin dhe unë besoj që do ta konsiderojë si shërbim publik. Vlerësoj gjithashtu dhe veçoj projektin e shëtitores që lidh katedralen me xhaminë, jo vetëm që do të ndikojë në zhvillimin e asaj lagjeje, në zhvillimin e qytetit, por jep edhe një mesazh shumë të fortë social. E kam thënë edhe në mbledhjen për paketën fiskale: Bashkia e Lezhës ka detyrimin që të vlerësojë të gjitha propozimet që i vijnë nga këshilltarët, sepse në fund të fundit ky është edhe thelbi i konsultimeve publike që ju dhe ne zhvillojmë. Ky është edhe qëllimi pse gjithsecili prej nesh jemi në këtë këshill bashkiak. Po e përsëris: ashtu sikurse për propozimet për paketën fiskale, për gjithçka, sugjerim, propozim që vjen nga këshilltarët apo edhe nga qytetarët gjatë konsultimeve publike, unë mendoj që një qëndrim i Bashkisë Lezhë është i arsyeshëm dhe i detyrueshëm. Në fund të fundit, po e përsëris: mundemi por s'duam, apo duam por s'mundemi. Pra, është shumë e thjeshtë çështja. Për ta mbyllur, unë uroj që të gjitha këto projekte që keni planifikuar për t'i realizuar, t'i realizoni në kohë edhe patjetër në cilësinë dhe standardet e duhura. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit zonja Marku për propozimet, por jo për pyetjet dhe ke kaluar 12 minuta, kështu që ezaurove dhe diskutimin. Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: Jo një herë, po për të disatën herë kemi diskutuar këtu që nëse merr dhe liston 20 gjëra, jo sot por edhe mbas 20 vjetësh zhvillim, edhe në Neë York po të shkosh, në nivelin më të zhvilluar në botë, ti gjen nja 20 gjëra. Unë e di se duhen, kushdo mund ta luajë, mund ta bëjë këtë ushtrim, mund të paraqitet mirë para zgjedhësve. Ne bazohemi në disa pika dhe prioritete. E para, bazohemi në ato që ne mbledhim shumë më tepër, taksa, dhe 61% të buxhetit e mbulojmë ne me të ardhurat tona. E dyta, këto të ardhura i adresojmë diku dhe kryesisht në investime, por edhe në mallra e shërbime që shkojnë në formën e investimeve në shumë fusha, sidomos në mjete, edhe në kanale kulluese, vaditëse, objekte të ndryshme, siç janë stacionet, etj, etj. Ne do kishim dëshirë t'i bënim të gjitha këto, por është e pamundur. Si mendoni ju se nuk kemi dëshirë ne si administratë që nesër në mëngjes të vihemi dhe të themi “do i bëjmë të gjitha”? Po, kemi dëshirë, po është e pamundur. Megjithatë buxheti vjen duke u rritur dhe është dyfishuar, ne nuk mund të pretendojmë akoma, se jemi akoma me baltë nëpër zona. Ne duhet t'i bëjmë lagjet edhe në zonat rurale ku ka qendra të banuara. Kryesisht jemi përqendruar te qendrat e banuara me hartë, që të shkojnë në shtëpi si njerëzit dhe të zhvillohet biznesi edhe në bregdet edhe në

thellësi. Tani disa sqarime që i bëjmë, unë nuk përsëris dhe nuk do sqaroj më as edhe një gjë. Sqarimet i kam dhënë shterruese, ka arsye dhe arsye bindëse, jo arsye kështu në tym. Ne këtu do jemi dhe jo njëherë, por tre here e nominova Balldrenin kur të tjerët thanë jo, po me tepricat, jo nuk do shkojmë me tepricat. Ne do shkojmë në Balldren sepse ndoshta mendojmë se nga prilli, maji, ne lirohemi nga efekti i ujësjellësit aty. Normalisht nuk kemi pse mos ta konsiderojmë. Do të mos ta konsiderojmë? Si urdhëron, ma thuaj teknikisht: si zgjidhet kjo punë, ta zgjidhim, po unë nuk di ndonjë shkencë teknike që ma thotë. Edhe në lagjen Nënë Tereza unë pretendoj se në mars me fillu, sepse do edhe një çik kohë ose më vonë, do kohë, pavarësisht se unë e kam nesër me e fillu rrugën aty, po varem edhe nga investimi, ashtu siç do varem në qytet nga ajo që është duke u bërë. Ashtu siç jam varur te lagja e Spitalit që është konfiguruar e gjitha. E para, njëherë do të bëjmë rrugë, infrastrukturën rrugore, po bëjmë pjesën poshtë, po bëjmë ujrat e zeza, po bëjmë ujrat e bardha, besoj e keni pare sa janë ato tubat ose kanalet e ujrave të bardha. Lezha do të dalë nga një ankth i përhershëm, se një e dy herë sa na bie shi aty, vrap media, vrap mikrofoni, këto që duan me bë politikë. E kemi adresuar gjënë, nuk thonë se është adresuar, po thonë “ka përgjegjësi” se ata nuk e quajnë atë që po bëhet, çfarë rëndësie ka, e dinë njerëzit, e shohin, e lexojnë, e përkthejnë më mirë se shumë të tjerë. Kështu që unë mendoj se ne kemi bërë edhe projektin për çerdhen e qytetit te shkolla “Kosova”. Po ka një kombinacion: se është një shkollë në rikonstrukcion aty dhe është spostu te ish-gjimnazi i vjetër, ku ne do çojmë “Kosovën” për të liruar ambientet, nuk veprojmë dot për një vit. Atëherë si do t’ia bëjmë? Do ta bëjmë me zor? Apo në Shëngjin duhet parë ajo, është e drejtë që duhet të shikojmë mundësinë e një çerdheje në Shëngjin për arsye se është rritur shumë Shëngjini dhe ka krijuar të tjera premisa. Pra, ne nuk është se nuk i kemi vlerësuar, por janë disa politika zhvilluese që të vijnë një nga një, nuk vijnë të gjitha përnjëherë. Pra, në qoftë se ti, për shembull, je në diskutim për gjithë Torovicën, që të gjithë ta fusin në një sistem me një investim që mund të shkojë 100 deri 150 milionë euro, më fal, po nuk ka shpresë më të madhe për zhvillimin e një zone se kaq, ndoshta nuk bëhet, por unë nuk kam si mos ta konsideroj; si mos ta konsideroj, të them jo?, unë jam ul në tavolinë me ta, më kanë shprehur, kemi folur dhe kanë lënë me ardh me grup këtu dhe me pa komplet, e kanë parë në hartë, u ka pëlqyer si zonë. Aty mund të ndryshojë një histori. Aty njerëzit nuk mund të jenë më, një gjë e harruar e në vështirësi, por do të jetë një tjetër histori që ka lidhje pastaj dhe me punësimin, ka lidhje dhe me zhvillimin, lidhen të gjitha gjërat. Ka lidhje edhe me të gjitha këto investime të mëdha, do shoqërohen edhe me kushte për investimet në komunitet, plus që të jetë, pra nëse do vijë një investim i madh në përmasa, do rregullojë rrugën, do rregullojë shkollën, do rregullojë çerdhen, do rregullojë atje, do i bëjë të gjitha. Kështu që ne nuk është se kemi harruar, ne nuk kemi harruar asgjë, por mos të hyjmë në politikën e pagesës së taksave, pastaj i bie që ajo njësi paguan vetëm 0,30%. Pra, mos ta gjykojmë kështu, se po morëm për referencë pagesën e taksave dalim keq, ju, se jo unë. Po të jetë ashtu për referencë taksash shkojmë, rimë në Shëngjin edhe në Tale, që paguajnë. Por edhe Shëngjinin, normalisht do ta merrte i pari kuotën e rrugëve, po si do ia bëjmë tani, se duhet me e bë se s'bën ujësjellësin! Tani ta rregullojmë të gjithë, do të thotë do presim edhe pak për rrugën, po do presim. Po në fund kur t'i bëjmë s'do i shqepim më, s'do i bëjmë çorap më. Jemi të detyruar me ecë edhe në një plan me vizion, me një mënyrë që ne ta zhvillojmë tamam vendin, jo të marrim lekë e të shpenzojmë, merr, shpenzo, merr, shpenzo. Pse s'bëmë në lagjen e Spitalit, as edhe një metër rrugë, pse nuk bëjmë te lagja Nënë Tereza gjashtë vjetë as edhe një metër rrugë? Ka një histori aty për kanalet e ujrave të zeza dhe sa për dijeni, te lagjet e Spitalit e kam marrë unë KFË-në dhe kemi shtuar dhe 600 milionë të vjetra investim, për arsye se kishin lënë kodrën te spitali. U kërkova që ta nxirrnin sipër, dhe tani e kanë marrë degën nga sipër, ku vijnë përrenjtë aty dhe e kanalizon dhe e çon poshtë, për arsye

se nëse nuk do futeshim deri afër kalasë, ne nuk do përfitonim asgjë. Dhe ne kemi qenë energjikë në këtë. I kam marrë, kam shkuar në këmbë vetë dhe u kam thënë: “Nëse ju nuk e merrni sistemin atje, stop, unë nuk firmos leje për këtë.” Dhe ashtu ka ndodhur. Ama jemi vonuar, kemi shtyrë edhe një gjashtë muaj të tjera, se kështu e kanë ata, nuk e kanë siç duam ne. Tani ka filluar dhe po dizajnohet. Menjëherë ne kemi hyrë me rrugët mbrapa. Tani edhe ato kanë një kohë kur na lënë me hy aty. Na duhet të kuptojmë skemën e zhvillimit. Diku ne jemi të kondicionuar, atëherë do çohen dhe Manatia e Grykë Manatia që kanë një problem uji madhor, siç kishte lagjia Nënë Tereza, siç kishte Gocaj Kakarriq. Ditën e tretë që kam ardhur unë kryetar bashkie, atëherë unë kisha fajin më të madh se s'kishte ujë në Gocaj Kakarriq, thjesht s'kishin asnjë faj. Kam shkuar unë dhe u kam thënë gjermanëve: do ma bëni një bonus se s'e kishin fare në hartë. Pse? Sepse është një zonë që me pak punë atje merr një zhvillim dhe ishalla ato çunat e kanë seriozisht atë punë që thanë. Se nëse ata e kanë seriozisht atë punë që thanë, nëse do e bëjnë atë projektin që kanë, unë po të them që ajo zonë jo vetëm që do punësohet njëherë totalisht, do krijojë një tjetër energji atje, do ketë prurje biznesi. Do ketë prurje deri në Mal të Zi e këtej e në Kosovë, do të ketë prurje aty. Dhe unë jam shumë optimist që ata do e bëjnë tamam dhe e kishin fokusuar mirë çfarë duhet me bë. E kishin studiuar mirë lidhjen mes Shkodrës, Malit të Zi, Kosovës, qendrës së Shqipërisë, me bë diçka që nuk është në Shqipëri, atëherë si mendon, mos na konsideroj? Po unë për sa kohë kam një ofertë në tavolinë si kryetar bashkie, s'mund të bëj sikur s'di gjë. Ama fakti që unë e them në këshill është transparencë. Se unë mund të mos ta them fare, po unë të them, unë kam një, dy, tre, katër oferta dhe jo për të thënë se unë jam duke shpëtuar vendin, po për të thënë se interesi i investitorëve të djemve tanë që kanë ikur andej është rritur. Mundësitë që ne u kemi dhënë janë pa limit, me zero interferenca negative dhe mënyra se si duan me e zhvillu ata është bashkëkohore, është diçka që nuk ngjan me një vend këtu. Edhe portin unë e kam negociuar, kam shkuar atje në Venecia. Si mos ta them unë? Aty do bëhet. Pra, duhet të jemi koshient për disa gjëra. 100%, ne s'kemi për t'i bërë as sot, edhe nesër kam për të dalë të tjera, edhe mbasneser do dalin të tjera. Por ne fillojmë e vëmë të paktën në rrugë një histori, e cila është shumë lodhshme. Dhe po të dëgjosh, po të marrësh për shembull një test sot, të paktën me çfarë kam parë unë, të gjithë te rrugët e kanë mendjen edhe nuk kanë faj. Të shkosh ti në bregdet në rrugë me baltë deri këtu, edhe kur ua bën, mos kujto se fiton ndonjë gjë të madhe. Në kuptimin “e ka pasë për detyrë”. Njëri thotë “jo po kështu”, tjetri thotë “jo po duhet dhe një trotuar”, tjetri thotë “po duhet”, edhe kështu e bëjmë rrugën. Se mbrapa kemi një projekt të dytë, që do hyjmë në të gjitha qendrat e banuara. Do hyjmë me trotuare, do shohim ku mund të shtojmë trotuare, ndriçim, trotuare. Ta kuptojmë buxhetin dhe mënyrën se si duhet. A shkojmë ne me shumicën e buxhetit për investime? A ndikojmë pozitivisht në shërimin e një plage që është realisht plagë, që është infrastruktura rrugore? Mund të lëmë diçka mangut, sigurisht mund të lëmë diçka mangut diku tjetër.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka zoti Gjinkola. Pastaj zoti Trashaj.

-Pjeter Gjinkola: Përshëndetje. Për portin e Shëngjinit një pyetje, sepse po presim edhe për dy investime të qeverisë në dy Ishujt. Më kryesore kisha për qytetin, lagjen e vjetër të Shëngjinit që është me zero infrastrukturë, a mund të ketë ndonjë projekt, ndonjë gjë? A do të pritët, a nuk mund të investohet para pa u bërë ujësjellësi. A mund të ketë ndonjëherë mundësi bashkia për të krijuar një qendër sociale për moshën e tretë? Dhe një ndër më kryesoret, pyetja numër tre është: te ANTAG-u do bëhet një terminal, dhe na ka rezultuar shpesh herë që japim këto toka, dikund e blejmë, dikund japim atë tokën e shtetit, dhe kur bie problemi në konceptin social dalim 100 % jashtë loje aty. A do të ketë ndonjë concept social ? Apo duhet të jetë masë drastike, kapitaliste,

me një fjalë, kush asht i zoti me shku me ndejt, se u tha se do të bëhet edhe një tip parkingu, kështu m'u duk, edhe stacioni, një tip parkingu, kështu e kuptova unë. Prandaj po i shtroj pyetjet në këtë mënyrë.

-Ndue Luli: Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: E para, dhe njëherë ju lutem shumë, mos më ricikloni gjëra që sqaroj. Sqarova edhe njëherë problemin e rrugëve të Shëngjinit edhe tek Shëngjini i vjetër. Aty nuk është se kemi bërë punë, kemi hequr ato fasadat e shëmtuara që kanë qenë për faqe të zezë. Ka pasur një realitet tjetër që ka bërë privati, këtej ka pasur një realitet tjetër që kanë qenë ato godinat e vjetra. Tani ju thashë, pretendojmë të hyjmë në sistemin e shpërndarjes së ujit dhe nëse do biem dakord, unë mendoj se brenda janarit do kemi takime me KFË-në për këtë punë. Kanë qenë një ditë te zyra ime, e kemi biseduar dhe nëse do hyjmë, ne nuk mund të bëjmë asnjë metër rrugë aty pa mbyllur problemin e ujit. Do bëjmë, s'do bëjmë! E dyta, porti i Shëngjinit, ka filluar përgatitja e dokumentacionit. Për terminalin, jemi në diskutim, sepse Pallati i Sportit na është premtuar dhe aty mund të ndërthuremi, me një parking poshtë, mes shtetit dhe privatit. Tani, terminali i autobusëve është i domosdoshëm për Shëngjinin, se ne nuk mund të lëmë më as autobusë as furgona të llojeve, kështu që bllokojnë trafikun dhe hyjnë në Shëngjin. Do hyjnë me makina të vogla, do akomodohen edhe në parking, kur qyteti ka marrë ngarkesë dhe ne nuk dimë nga t'i themi. Do shkojmë me taksi? Apo do krijohet edhe një terminal autobusash ku do hyjnë autobusët, se s'kemi një vend ku t'i akomodojmë dhe duhet ta bëjmë. Pra, kjo është në kuptimin social për të përmirësuar jetën dhe cilësinë e turizmit atje. Normalisht që ka përfitime sociale. Sa i përket qendrës së moshës së tretë, shohim ndonjë ambient, mund ta bëjmë. Të bëjmë këtë të Lezhës njëherë se e kemi në proces dhe mendoj se deri në fund të janarit fillojmë punë, sapo të hapim shesh pushimin atje. Jemi duke bërë hapa përpara, po secili ka radhën e vet.

-Ndue Luli: Zoti Trashaj, pastaj zoti Artan.

-Alfons Trashaj: Përshëndetje të gjithëve.

Me të vërtetë është projekt buxheti më i madh që kemi dëgjuar dhe shohim se zona e Zejmenit ka marrë më shumë investime nga Bashkia Lezhë. Unë them që ka marrë më shumë investime, sepse kanë qenë taksapaguesit më të shumtë dhe ka sjellë më shumë lekë në arkën e bashkisë, dhe aty ku paguhet, aty duhet të punohet më shumë.

Zoti kryetar i bashkisë, për pritash malore, nuk dëgjova që mund të keni ndonjë projekt. E dyta, parcela të reja pyllëzimesh, për të mbrojtur erozionin ose mirëmbajtja e pyjeve. Një saktësi më të madhe për zjarret gjatë verës, a ka ndonjë zgjidhje më të mirë, një investim më të mirë? Dhe rrugët e reja që bëhen, zoti kryetar i bashkisë, i kemi pare dhe në rrugët e tjera që janë bërë, të investohet pak më mirë në tubat shkarkues, sepse të gjitha ujërat i nxjerr në asfalt. T'i shtohet pak buxhetit të asaj rruge. Kaq kisha, këto pyetje kisha, faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Tani, ne nuk kemi hyrë me i thënë të gjitha. Ndërtim pritash malore në degëzime të Përroit të Bardhë dhe rehabilitimin e urës së fshatit Zejmen, Njësi Administrative Zejmen, pra që të hyjmë në Zejmen me emergjencat dhe mund të hyjmë prapë me një projekt emergjencash që mund të na vijë nga qeveria. Sistemi i përroit, disiplinimi i ujërave në dy degëzime të përronjve malorë në lagjen e Re Markatomaj, njësi administrative Zejmen. Plus që kemi hyrë edhe te rrugët e katundit tënd atje Në Pllanë, çfarë keni dashur ua kemi bërë, firma ka një limit

prej 5% ku ne po luajmë, edhe në lagjen frutore ne mund të fillonim që nesër, por jemi duke bërë një sistem shkarkimi njëherë me firmën që të devijojë ujërat në Drin në momentin kur bie shi. Pra, ka një problemi Zejmeni kësaj radhe, ka shfaqur një problem aty, që unë u kam thënë: "Gjeni burimin e atij problemi dhe ne ta mbyllim," se nuk e kemi pasë, kësaj radhe e kemi pasë, si duket ndoshta sasia e shiut ka qenë përqendruar më shumë në atë zonë. Se diçka ka ndodhur, meqenëse edhe përpara u përmenden këto përmbytjet, po ju them edhe njëherë në këshill, e para e punës, ai është kanal i ujërave të larta dhe menaxhohet nga Bordi i Kullimit dhe Ministria e Bujqësisë, jo nga Bashkia Lezhë. Se u çua i madh e i vogël me dalë në televizor e më kishin në mendje mua. Unë isha atje, interlokutori i mobilizimit të gjithë institucioneve për të mos agravu pasojat në njerëz, unë nuk isha përgjegjës i drejtpërdrejtë asaj situate, dakord. Kështu që gjithë entuziazmi që shprehën nëpër media se akt kriminal, kanë bërë kështu, pallate, këto janë ca përralla që tregohen nëpër ca lokale dhe i marrin pa bluar fare nëpër media. Kjo është një histori banale politike që ndodh por ne do ta mbajmë në kurriz, se s'kemi ç'të bëjmë. Pra edhe njëherë po ju sqaroj, unë isha atje për të mobilizuar institucionet dhe për të bërë rregullatorin mes Ministrisë së Bujqësisë, ushtrisë, kompanive private, për mos me e lënë situatën me u agravu. Dhe nuk shpërtheu herën e dytë argjinatura që kishim bërë ne, por ishte në një pjesë tjetër fundore të ranës dhe u detyrum me ndërhy edhe njëherë dhe nuk besoj të ketë problem më. Por janë aksidente që ndodhin në gjithë botën, ndodhin, e çfarë do bëjmë ne? Në qoftë se ndodhin aksidente të tilla do mobilizohemi, do rrimë atje pa gjumë, do të dëgjojmë komentet e këtyre që kanë qejf me i bë, le të bëjnë çfarë do bëjmë, por unë ndihem krenar për mobilizimin absolut. Unë ndjehem krenar për të gjithë. Ka pasë të paktën nja 30-40 banorë që kanë ndenjur deri në mëngjes atje, njëri drejtonte makinat, tjetri ishte teknik ndërtimi, e thoshte bëhet kjo, dhe tjetri të bëhet atje, e tjetri shkante bënte ca petulla me djathë, e na i sillte. Ishte një solidaritet absolut, absolut dhe ne kemi bërë një menaxhim spektakolar. Jam krenar për të gjithë atë punë që kemi bërë atje dhe parandaluam një katastrofë. Parcela të reja për pyje, ke të drejtë që duhet, por edhe ky sistemi i menaxhimit të pyjeve edhe nga privatët duhet stimuluar. Duhet stimuluar dhe ju nëpër njësi, këshilltarë jeni, duhet të angazhoni njerëzit sepse pyjet janë atje, por duhet t'i marrë dikush edhe në administrim, edhe t'i mirëmbajë, edhe të përfitojë nga ato. Tashi jo të gjitha, gjithë territori, ne mund ta mbulojmë si bashki, është e pamundur, prandaj ka dalë ai ligji për t'ua dhënë në përdorim dhe s'ka asgjë të keqe këtu, se duket sikur ça po ndodh, por as i fal tokë, as e vjedh tokën, edhe e merr me një program sipas rregullit, sipas ligjeve. Për zjarret presim që këto zjarrfikësit mos i kemi më, do të përqendrohen atje në Bushat me sa di unë, ishalla bëhet, se ç' do bashkia me u marrë çdo verë me zjarret. Se tani edhe kur bie zjarri, e kam vu unë, sa herë bie zjarri plas uji, e kam fajin unë, si tha ai e ka fajin Saliu, edhe mua kështu më ka gjetë. Qeveria ka bërë një projekt që edhe ta financojë me mjete dhe t'i përqendrojë, domethënë është krejt normale që bëhen nja 10-15 zjarrfikëse dhe nëse bie zjarr në Lezhë sulen në Lezhë të gjithë, sivjet ne ndërtuam një sistem më të shpejtë të reagimit, pra të marrjes dhe të reagimit, dhe prandaj filluam i parandaluam dhe zjarrfikësit kanë punuar me nga 10 zjarre në ditë, edhe 15 ka pas një natë, por ama nuk e kanë lënë situatën me u agravu, sepse kanë vepruar shpejt. Ka pasë raste si në Krajën e Dajç, Kallmet, kanë dalë banorët vetë, s'kanë pritur, kur kanë shku zjarrfikëset kanë pasë kryer punë. Ka pasë edhe rast kur na thoshin ne, tu dal flakë aty, rrinin kështu "Ju e keni për detyrë", po edhe këto do i kalojmë.

-Ndue Luli: Zoti Artan. E tërhoqe? Ok. Zoti Gjon Marku.

-Gjon Marku: Faleminderit kryetar, përshëndetje të gjithëve. I rikthehem edhe njëherë Njësisë Administrative Ungrej, përsa i përket buxhetit, është me zero investime për vitin 2026, edhe pse

nga kryetari i bashkisë është premtuar në dëgjuesat publike, 2.5 km rrugë, rruga e Qafës së Pazari, aty në buxhet nuk po e shikojmë. Përsa u përket tepricave, se po flitet për teprica, një pjesë e rrugëve po bëhet me teprica. Tepricat besoj nuk janë planifikim apo garanci. Tepricat janë çfarë mund të realizojmë tjetër. Kaq kisha, faleminderit.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, më vjen shumë keq, ne flasim një gjë e ju flisni tjetër gjë, unë i thashë, kemi heq sot në buxhet dhe kemi sjellë një projekt, ku ne kemi propozuar sot një skemë tjetër, do heqim dy rrugë në Zejmen dhe do të financohet rruga atje që është premtuar në Kalivaç, dakord. Pra, do të financohet tani, jo tepricat për arsye të balancimit të buxhetit, atë që thamë. Po të jetë puna për investimet në raport me numrin e popullsisë, jeni në vend të parë në gjithë këto vite, në vend të parë, dakord. Për numrin e popullsisë, 2500 banorë ka, për numrin e popullsisë dhe për sasinë e lekëve që ka derdhë qeveria dhe bashkia atje, keni vend të parë, dakord. Çdo vit ne kemi adresuar teprica nga 1 miliard, nga 800, nga 1.2 kemi adresuar dhe ne vetëm në proces këto ditë kemi të paktën na katër leje ndërtimi që bëjnë nga katër miliardë. Tani ku t'i çojmë ato apo nuk quhen, si të bëjmë, se kjo logjika juaj që tepricat janë, çfarë janë tepricat? Tepricat janë lekë që ngelin këtu dhe do të adresohen, nuk i fut dot në buxhet sot, se nuk i shpenzon dot, po nesër je i detyruar me i adresu. Nesër, po të them unë ty, përveç planizimit që kemi ne, mund të shkojmë dyfishin e planizimit në të ardhurat, për arsye të asaj që janë në fund, të gjitha lejet që janë bërë janë në fund të realizimit dhe besoj gjashtëmujorin e parë ne do i marrim të ardhura më shumë se kemi. Atëherë, ti mund ta bësh edhe në shtator një rialokim fondi në qoftë se ke burime financiare, të ardhura mbi kuotën e planizuar. A keni parë edhe qeverinë që bën rialokim fondi, ose merr disa gjëra që nuk i realizon dot, se ka edhe në buxhet, ka gjëra që nuk realizohen për shkak të pamundësisë së prokurimit: dështon njëherë prokurimi, dështon njëherë, shkon në fund s'bëhet më, çfarë t'i bëjmë ne, dhe detyrohemi me marrë lekë këtu me i çu këtu, ose del një emergjencë, detyrohemi me heq një x gjë se ka dalë një emergjencë x vend, ne detyrohemi me u fokusu kështu. Ju kam thënë dhe njëherë, edhe buxhetin e familjes tënde nga e hëna deri të dielën, ti s'mundesh me ia vënë pikat një, dy, tre, 10, edhe të dhjeta me të dalë, siç i bën ti ditën e hënë, se të del ndonjë gjë e paparashikuar.

-Gjon Marku: Po flasim për investime, jo për shpenzime zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Për investime po them pra. Të thashë edhe njëherë, është buxheti, në kuptimin e buxhetit dhe një buxhet i vogël i shtëpisë nuk komandohet dot, jo më një buxhet bashkie.

A ngrite një pretendim? A ta dhashë përgjigjen që s'ke të drejtë, se e kemi bërë sot ne propozimin për ta hequr dhe për ta ndryshuar. Dhe kjo seancë për atë punë është, ti mund ta rrëzosh poshtë gjithë buxhetin e të ndërtosh një buxhet të ri, për çfarë është seanca, ky është projekt, propozim, propozimi mund të ndryshojë nga një zë në një zë tjetër, sikur e kemi konkluduar për shembull që ajo rruga të bëhet fillimisht, se ajo rruga duhet të bëhet fillimisht, se ju bërtisni më shumë se të tjerët, e s'paguani asgjë. Apo do me pa sa paguajnë taksa aty, dhe ta shohim se del më keq.

-Gjon Marku: Është problem i juaji, jo i joni.

-Pjerin Ndreu: Është problemi i qasjes, i mentalitetit që atje s'duhet të paguajnë asnjë gjë dhe duan të marrin gjithçka, ashtu është, po ta them publikisht, është mentaliteti i një zone të tërë, ku bërtasin për me marrë, po për me dhënë asgjë, edhe ju kemi dhënë më shumë se të gjithë njësitë, se të gjithë njësitë bashkë i kemi dhënë njësisë Ungrej, me ura, me kanale, me rrugën, me rrugë prapë, me të gjitha, rrugë prapë, që edhe projektin e rrugës së Kaluerit e kemi, që vitin tjetër

besoj do ia marrim qeverisë. Pra i kemi konfiguruar gjërat aty, për me bë edhe rrugët, edhe degëzimet.

-Ndue Luli: Zonja Ndoj po.

-Donika Ndoj: atëherë, për sa i përket këtij projektbuxheti, në fakt është një buxhet që do ta kishin lakmi edhe vendet e zhvilluara, por në ndryshim nga ato është sepse ato nuk e shtrydhin biznesin lokal edhe qytetarët aq sa do të rëndojë këtu tek buxheti. Sepse do rëndojë tek biznesi. Edhe me ato tarifat e dyfishta, ndoshta do të ketë vështirësi edhe në mbledhjen e këtyre taksave dhe tarifave, tek paketa fiskale që e kemi miratuar që muajin e kaluar, kishte disa biznese që ishin rrit ato. Atëherë, ajo që më prek më shumë është në lidhje me këtë, e preku pak kryetari në lidhje me terrenet sportive, përpos rrugëve, dhe ok, jam shumë dakord për këto investime shumë të rëndësishme për terrenet sportive, sidomos që e përmendët vetë në Torovicë, edhe në Zejmen dhe tek një fushë tjetër në Dajç, që mendoj që është një investim koherent për të rinjtë dhe mendoj se duhet t'i mëshohet më shumë këtij zëri për arsye për të integruar këta të rinj, dhe së dyti, mendoj, a do ta zgjidhë përfundimisht ky buxhet rehabilitimin e ujësjellës kanalizimeve për qytetin e Lezhës, ky buxhet 2026, a do ta zgjidhë përfundimisht këtë problem? Hapet një rrugë, mbyllet një tjetër, kështu që ta mbyllim këtë histori, megjithëse diskutuat po, që të japim fund me gjithë këtë buxhet galopant që po përmendet, sytë dhe veshët e qytetarëve janë këtu tek ju, te këshilli, edhe tek këto investime konkrete në terren. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: E nderuar këshilltare. Më vjen çudi, se je në të njëjtën llogjikë me ca shkresa që i kam marrë sot se më ka ardhë me qesh në fakt, po ujësjellës kanalizimet nuk janë investime me buxhetin e bashkisë. Ujësjellësi dhe bypassi i Shëngjinit janë investime të qeverisë por me projektet tona. Kjo është e KFË-së, qeveria shqiptare ka miratuar kredinë për të bërë sistemin e kanaleve të ujërave të zeza e të bardha të Lezhës. Kemi lobuar ne me kryeministrin, që mos ta heqin gjermanët, se ra pandemia, u bë ajo që u bë. Është e KFË-së, ne kemi lëshuar lejen. Ne sot i kemi gati me i bë nesër rrugët, me i fillu të gjitha, po nuk i bëjmë dot. Do fillojmë këto rrugë që nuk i kap projekti.

Sa për biznesin, në gjithë botën peshën kryesore e mban biznesi. Madje, sa për dijeni, norma e fitimit të biznesit në Shqipëri, sidomos në ndërtim, me disa është me nga 300%. Biznesi i huaj ka zero taksa, s'ka taksë fare. Biznesi i vogël ka vetëm tarifa që ne nuk është se kemi bërë një ngritje, s'ka ndryshuar fare dhe nuk ka ndonjë barrë fiskale. Po ata që janë ndotësit më të mëdhenj, që na krijojnë problemet më të mëdha, normalisht që ata do të mbajnë koston e gjësë, sepse ne do hyjmë në këtë situatë, po pikë së pari biznesi do marrë koshat e vet. Biznesi i vogël, të vogël, biznesi i madh, të madh. Të paguajnë vetë drejtpërdrejt ekstra, sepse sa prodhojnë ata dhe sa paguajnë, janë në disproporcion shumë të madh dhe jemi detyruar me pagu ekstra te kompania që tërheq mbetjet, sepse është një histori që nuk ka lidhje me dëshirën time, po apo jo, duhet apo s'duhet, duhet se fëmija jot e i imi kalon aty. Përballë konviktit, s'ka turp më të madh se aty! Tani do hyjmë ne me sistem kamerash, me të gjitha, do i rregullojmë këto punë edhe me ndëshkime, edhe me minikamera. Çfarë i kushton një familjeje me i fut në qese edhe me i lënë në orën që caktojmë ne? Normalisht që në vitin e parë do na duhet me shpenzuar më pak, se futet në lojë administrata, futen në lojë mjete të reja, futen në lojë kosha të rinj, pra ne bëjmë një revolucion edhe në qasje, se ne nuk do rrimë me këto rrangallat që na kanë lënë nëpër fusha aty. Ne do hyjmë dhe do transformojmë komplet sistemin, do i heqim komplet në zona rurale, asnjë

s'ka për të mbajtur kosh ose përjashto biznesin që do e mbajë vetë në objekt, aty ta gjejë hapësirën, apo jashtë, aty ta mbajë, se i mbajnë në të gjitha zyrat në botë.

-Ndue Luli: Zoti Tushaj e ka fjalën.

-Pjeter Tushaj: Faleminderit zoti kryetar, më bëhet qejfi se të gjithë këshilltarët bënë kërkesat e veta që janë këshilltarë atje dhe e dinë shumë mirë. E dyta, meqë kam me vite këtu edhe në Shëngjin, duhet të shikojmë mbrapa, siç kemi qenë edhe si jemi. Për në Shëngjin, diskutoi kolegja ime, Regjina, me të drejtë, edhe u tha që do të bëhen punimet e ujësjellësit dhe do të bëhen punë të tjera. Edhe ajo çerdhe është e domosdoshme, varet se si mund të vijë terezia. Pjesa tjetër, në Shëngjin kemi vuajt për ujë, për drita dhe tash dy vjet, të them të drejtën, asnjë nuk e di nga ju që s'jeni atje, edhe ujë e drita kemi pasur, të paktën vjet patëm ujë. Unë, meqënëse jam edhe anëtar këshilli, kam një vërejtje për rrugët e reja që bëhen, nuk ka asnjë lloj tabele, se ato i prishin makineritë e rënda. Është normale, se ato janë rrugë që nuk durojnë pesha të rënda, duhet të vihen ca tabela. Kaloj, shoh betoniere, për me eliminu atë pjesën e qarkullimit, i bien rrugëve të shkurtra kurse për pjesën e pastrimit, njerëzit duhet të edukohen, zoti kryetar. Atje në Shëngjin, na vure një rregull me pjesën time ku jam, që koshat do të nxirren në orën 1 të natës, sa mirë i nxjerr unë ato koshat në orën 1 të natës edhe vjen e i merr ajo makina. Pra, njerëzit duhet të edukohen për pastrimin, se normal pjesa tjetër e pastrimit është perfekt. Me thënë të drejtën, bashkia ka progres, për me fol sa të duash kam edhe unë kërkesa atje që e shoh gjithë ditën. Zoti kryetar i bashkisë ka shumë përgjegjësi, po ky, me thënë të drejtën, ia them edhe shoqërore, merr shumë përgjegjësi edhe për gjëra që nuk ka ky. Pastaj vijmë e diskutojmë këtu, jo kështu, jo ashtu, por merr shumë gjëra përsipër, që ka elektrikun, bordi i kullimit, kjo pjesa tjetër, zotëri të lutem të mbajnë përgjegjësi ose duhet t'i thërrasim këtu në këshill, që të japin llogari për këtë punë, kështu që ta bëj një tip vërejtje personale-shoqërore më shumë, meqë jemi miq kaherë, kështu që ato përgjegjësitë mos i mbaj krejt vetë se do bësh kolpo masandej. Fajin e ka Pjerini masandej.

-Ndue Luli: Faleminderit zoti Tushaj. Po zoti Jaku.

-Tonin Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Kisha nja 2-3 gjana. Ndjem mirë për investimet që janë bërë, konkretisht në njësinë Zejmen, dhe ato që do bëhen në vitet në vazhdim. Ndjem mirë për lagjen Vukaj, që pashë që ishin tre rrugë, tre degëzime që mendoj që do të plotësojnë, sepse ajo është një lagje vërtet e komplikume për çështjen e mbetjeve. Mbi 50% të mbetjeve i hedhin në lumin Mat, mendoj që të shikohet edhe rruga e burgut që i themi ne, nuk dëgjova asgjë për sistemin ujitës për njësinë Zejmen, për vitin 2026, besoj që nuk është parashikuar asnjë gjë, dhe e fundit që kisha, në ujësjellësin Manati, nuk ka përfunduar, dhe ajo që më shqetëson është që janë asfaltuar dy rrugë realisht edhe pa përfunduar ujësjellësi. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit zoti Jaku. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: E thamë që do e bëjmë lagjen Vukaj, se i hedhin plehrat në kanal, mirë që ma the.

Do të ndërtohet sistemi i menaxhimit të mbetjeve, ku do i nxjerrim te rruga aty në cep. E dyta, në Zejmen janë të planifikuara për vitin 2026, 17 km kanale kulluese dhe vaditëse, të futura në plan. Në vitin 2027 janë 18. Pra, ne nuk kemi lënë asnjëherë punën me kanalet atje dhe do të vazhdojmë ta bëjmë me kanalet kulluese dhe me kanalet vaditëse. Ne jemi duke e parë me shumë vëmendje dhe mendoj se pesha që i kemi dhënë njësisë Zejmen, pavarësisht se gjenden një, dy,

tre, pesë gjëra që normalisht është e pamundur që të realizohen, në raport me buxhetin, njësia Zejmen besoj mban medaljen e tërheqjes së investimeve, për arsye të të qenit njësia më kontribuuese me taksa. Pra, vetëm sistemi i rrugëve që ndërhyjmë në Pllanë në kësaj radhe, pa atë rrugën që thu ti që është një projekt tjetër që duhet të bëhet dhe ajo duhet të mbyllet. Po, është pak e gjatë ajo dhe na krijon pak kosto. Pra, nuk bëhen të gjitha, ne jemi duke u munduar të bëjmë maksimumin e mundshëm, pra të trajtojmë rrugë, të marrim bllok lagje dhe t'i adresojmë. E kemi bërë aty te shtëpitë e tua që bëjmë bllok lagje aty, komplet i mbyllëm dhe kalojmë te Vukaj. Pra, fillon, merr lagjja mbrapa te Margekajt që kanë ngelur edhe nja dy degëzime aty që kryen punë Alfonsi me shokë, edhe mbaron filmi. Pra, bëhet Pllana komplet, vetëm një rrugë ka ngelë. Për ujësjellësin e Manatisë është bërë projekti, është mbyllur, është paraqitur për financim. Financimin e ka në dorë qeveria me AKUK-un, pra është bërë projekt, s'ka pasur projekt për financim. Presim sivjet që të financojmë me KFË-në Shëngjinin dhe me qeverinë Mabë-Dragushë dhe Manati- Grykë Manati.

-Ndue Luli: Zoti Kosova e ka fjalën.

-Soveljan Kosova: Faleminderit. Disa gjëra në lidhje me projekt-buxhetin, mendoj se diçka duhet të ishte parashikuar apo mund ta shikoni për në vazhdim. Në Shëngjin kemi një vijë bregdeti ranore e cila do të mbushet çdo vit, çdo muaj.

-Pjerin Ndreu: S'është kompetencë e bashkisë ajo, janë institucione të tjera, ne jemi duke u mundu. Jam dakord me shqetësimin.

-Soveljan Kosova: Do vijë koha kur do investoni te rruga aty bregut të detit dhe do përdoret si argjaturë. Mund të influenconi tek institucionet e tjera. Është problem shqetësues me të cilin nuk po merret askush, asnjë institucion. Do jetë shumë vonë kur të ndërhyhet. E di se nuk mund të bëhet me fondet e bashkisë, por besoj se ndërhyrja apo një studim alternativ, me ju paraqit atyre institucioneve të tjera, do ishte i nevojshëm. Nuk besoj se do ndërhyhet pa ndërhyrjen tuaj me forcë.

Në lidhje me Balldrenin, nuk do zgjatëm shumë, por në lidhje me ato diskutimet për kompanitë e mëdha që afrohen, kemi ca eksperiencë të një kompanie aty në Zadrinë e cila ka filluar prej vitesh edhe nuk është askush. Kështu që nuk jam shumë i prirur që të var të gjitha shpresat se do investojnë kompani, do i japin zgjidhje infrastrukturës, do i japin zgjidhje shumë problematikave të zonës. Janë me dëshirën e plotë që t'i presim edhe shpresoj që të vazhdojnë dhe të investojnë, po historia ka treguar që nuk është se dalin shumë gjëra të mira në këto pritshmëri.

Pastaj, në Balldre ka mundësi që të investohet diçka e thjeshtë, ndriçimi i Balldrenit, që mund të bëhet shumë kollaj. Besoj se edhe ato projekte të cilat janë realizuar në kohë, nuk po menaxhohen aq mirë në lidhje me ndriçimin, kështu që duhet me i pa.

Një problematikë që na ka ngelur, domethënë, prej shumë vitesh, që kur e kemi filluar për të bashkëbiseduar këtu në këshill — rruga Milot-Balldren, po flasim për një kompani private që pretendon të investojë në fushën e Torovicës me 150 milionë euro, dhe diskutojmë një projekt qeverie prej 10-11 vitesh, edhe nuk po merr dritën jeshile. Çdo justifikim, çdo paraqitje publike e mosfillimit apo mostenderimit i ka kaluar, domethënë, i ka dalë boja 100%. Asnjë justifikim më, nuk besoj se ky publik, ky popull, këto njerëz, ky rajon mund ta kapërdijë. Kështu që, nëse keni mundësinë me influencë pak më shumë, sepse ka shkuar atje ku çdo lloj projekti, çdo lloj arterie e zhvillimit të ekonomisë së këtij qyteti, kësaj bashkie, edhe pak më gjerë, është e lidhur me të.

Nuk mund të flasësh as për portin, nuk mund të flasësh as për investime të tjera, te dalja në Balldre apo atje, domethënë, kur nuk dihet se kur i teket ministres ta kthejë, ta rikthejë, ishallah merr zgjidhje. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit zoti Kosova. Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: Nga kjo pjesa e erozionit nuk është se s'kemi bërë asgjë. Unë jam konsultuar disa herë dhe besoj se do ta gjejmë një mënyrë. Dhe aty ka ca kënde që duhen respektuar, ca studime që unë i kam pyetur edhe këta të Institutit të Gjeoshkencës, kanë thënë: "Ne mund të vijmë ta bëjmë." Një djalë prej Lezhës më ka thënë do të sjellë një ekspert prej Hollande, mund të vijë ta shohë. Me qeverinë ne kemi biseduar që si mund ta bëjmë, ne bëjmë një projekt dhe edhe privatët janë gati për të ndërhyrë në atë punë. Pra, nuk është se nuk jemi marrë, po nuk është detyrë e jona, në buxhetin tonë që ta adresojmë ne. Është ajo historia e ndërmjetësit që duhet ta luaj unë me qeverinë, për të adresuar dhe atë punë, edhe jam duke e bërë.

Ndriçimi është futur në sistem aty.

Tani, Milot - Balldreni, ka kaluar të gjitha procedurat, pra është mbyllur si kapitull në kuptimin e procedurës, për herën e tretë. Tani, nuk është vendi këtu në këshill me tregu se si e qysh e tek, por unë e kam mbajtur personalisht qëndrimin shumë të prerë me kryeministrin për punën e Milot-Balldrenit dhe unë shpresoj që brenda vitit të ri të firmoset sepse ajo vetëm ka ngelur, shpallja e fituesit ka ngelur, asgjë tjetër. Po ndodhën ato që ndodhën, edhe ju e dini çfarë ndodhi. Tani, unë mendoj që s'ka më kthim mbrapa dhe publikisht unë e kam thënë tek "Opinion", Lezha ka vetëm një shpëtim: Milot - Balldreni. Tani ka dhe turbulenca atje. Se në vend që të çohen e të flasin deputetët tanë, të majtë e të djathtë, për Milot-Balldrenin, shkojnë njëri më shan mua, e tjetri shan ata. Pse nuk bëhemi një të gjithë me këshilltarë, me deputetë të majtë e të djathtë? Të gjithë t'i kërkojmë qeverisë pse vonon. Jam dakord, hajde ta bëjmë. Unë s'kam ndonjë kompromis me kërkënd për rrugën. Unë bëj kompromis për çfarë të duash në Lezhë sot. E kam identifikuar dhe jam plotësisht i bindur se zgjidhja përfundimtare, për frymëmarrjen e turizmit, të qytetit dhe të zonave përreth është Milot-Balldreni, se shkarkon. Nëse nuk do bëhet ajo, nëse do ndodhë një ngecje, që mua s'ma merr mendja, se unë e kam biseduar me kryeministrin atë punë, por është i drejtë shqetësimi. Po mos kujto se unë e kam lënë këtë në hije, përkundrazi, jo vetëm s'e kam lënë në hije, po kam ndërhyrë në mënyrë energjike që kjo punë të bëhet. Tani a 10, a 11 vjet, a 12, mua s'më rezulton aq, por gjithsesi duhet të ishte bërë.

-Ndue Luli: Tjetër kush e do fjalën? Nuk ka. Atëherë kush është dakord me projektvendimin me ndryshimet që u thanë edhe nga kryetari i bashkisë në lidhje me projekt-buxhetin e vitit të ardhshëm. Miratohet me 29 vota Pro. Këshilltarët Alfrida Marku, Gjon Marku, Emanuel Perjaku, Donika Haxhia, Soveljan Kosova votuan Kundra, pra 5 vota Kundra. Abstenim asnjë. Faleminderit.

Kalojmë te pika e dytë, projekt-vendim "Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027". N lidhje me këtë, kush ka ndonjë vendim? Nuk ka. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota Pro.

Kalojmë te pika e tretë, projekt-vendim "Për lënien në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm".

Në lidhje me këtë dua të sqaroj që në mbledhjen e kaluar e shtymë për sot dhe mbledhjen e janarit do të sjellë informacion edhe drejtoria përkatëse për furnizimin me ujë. Në lidhje me projekt-vendimin ka kush diçka? (Flet zoti Gjinkola në lidhje me cilësinë e ujit)

Po edhe kryetari tha pak më parë që do bëhet fjalë për një fazë të dytë në lidhje me ujësjellësin e Shëngjinit.

Atëherë, në lidhje me projekt-vendimin, po zonja Marku.

-Alfrida Marku: Unë mendoj që ne si këshill bashkiak edhe ju, zoti kryetar i bashkisë, sot duhet të konkludojmë me një qëndrim unanim për uljen e tarifave të ujit të pijshëm. Dhe nuk më duket e arsyeshme që ne të na propozohet për diskutim dhe votim projekt-vendimi për lënien në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm. Të gjithë e dimë që në mars të 2024-s, tarifat e ujit të pijshëm për Lezhën janë rritur në masën 12%. Edhe në mbledhjen e kaluar ju u shprehët që duhet që këshilli bashkiak dhe Bashkia e Lezhës të dilnin me një qëndrim për uljen e këtyre tarifave, si dhe propozuat që në këtë mbledhje të kishim praninë e drejtuesve të shoqërisë ujësjellës-kanalizime Lezhë për të raportuar mbi menaxhimin financiar nga ana e tyre. Kështu që është ajo shprehja: “Midis asaj që thuhet dhe asaj që bëhet ka në mes një det.” Por unë mendoj që s’ishte e nevojshme që kjo shprehje të konkretizohej në këtë rast. Kështu që pyetja ime është: i qëndroni angazhimeve të mbledhjes së kaluar? Dhe propozimi im është që ne si këshill bashkiak dhe ju si drejtues të bashkisë të konkludojmë në mënyrë unanime që tarifat e ujit të pijshëm duhet të zbriten dhe jo me këtë projekt-vendim që t’i lëmë në fuqi tarifat aktuale.

-Pjerin Ndreu: Mirë, të bëj një sqarim tani. Unë i rri pikë për pikë asaj që kam thënë dhe mësoni edhe njëherë që kur e artikuloj me gojën time, jam menduar dhe e them. Kemi hasë në vështirësi me projektin e ri të grupimit në bazë të kësaj, jo për fajin tonë, por për faj të sjelljes së Entit Rregullator të Ujit. Ajo që më shqetëson mua (dhe s’e kam problem ta them, ua kam thënë edhe atyre të AKUK-it) është që ujësjellësi i Lezhës ka qenë rentabël deri në ditën kur u bashkuan, Kurbinin dhe Mirditën kanë qenë gropë. Tani gropat e Kurbinin dhe të Mirditës janë duke u mbushur me një çmim që ne na është rritë. Tani ne do të kërkojmë një pasqyrë financiare që të shikojmë gjendjen. O zotëri, po, ti kishe kaq lekë shpenzime, more edhe kaq lekë të ardhura, sa lekë more nga shtesa e pagesës, sa lekë t’u shtuan? Ku i çon këto lekë, ku janë të reflektuara? Unë mendoj që duke bërë këtë, ne duhet të marrim si këshill, si bllok, në mënyrë kolegjiale, një iniciativë gjyqësore, për shkak të vjedhjes që i bëhet taksapaguesve lezhjanë. Në kurriz të tyre mbushen gropat e të tjerëve, pikë për pikë. Qenia e sotme këtu nuk u var nga unë. Kryetari më tha që është një histori që duhet ta trajtojmë pak gjatë kur ta thërrasim, dhe përderisa kemi buxhetin që shkon gjatë, mos t’i bëjmë në të njëjtën seancë të, dyja por ta lëmë në janar, direkt në mbledhjen e parë ose e bëjmë jashtë radhe, e bëjmë vetëm për ujësjellësin, e marrim në shqyrtim tamam atëherë.

-Ndue Luli: Atëherë, në qoftë se do ta lëmë për mbledhjen tjetër, Enti Rregullator i Ujit ka të drejtën, mbajeni mend mirë këtë që po them, ka të drejtën të vendosë edhe për me e rritë çmimin, pra duhet brenda këtij viti, e kalojmë, se ata e rrisin edhe pa na pyet ne. Por, në qoftë se ne nuk reagojmë në këtë rast, ata mund të marrin një vendim tjetër që e dinë vetë ata si e marrin. Kurse, përsa i përket shtyrjes është kjo që e sqaroi kryetari, duke parë edhe ngarkesën që kemi pasur për sot, menduam që në mbledhjen e janarit ose me mbledhje të jashtëzakonshme, me propozimin e një të tretës së anëtarëve të këshillit, ju e dini, mund të bëhet edhe mbledhje jashtë radhe për të

marrë në shqyrtim një dukuri të tillë e cila është problem jo vetëm i joni, por i gjithë komunitetit të Lezhës.

Atëherë, Në lidhje me çmimin, kush është dakord që ky projekt-vendim të kalojë dhe të jetë në fuqi? Ju lutem kartonat. Miratohet me 32 vota Pro. Këshilltarët Alfrida Marku dhe Gjon Marku nuk votuan.

Për tjetrën e thamë dhe do ta mbajmë fjalën së bashku, jo unë, por bashkë me ju.

Atëherë, vazhdojmë me pikën 4, projekt-vendim "Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionin e qirasë për vitin 2016".

Në lidhje me këtë, ka kush diçka? S'ka. Kush është dakord me projekt-vendimin? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota Pro. Faleminderit.

-U largua këshilltari Emanuel Perjaku.

-Ndue Luli: Kalojmë te pika 5, projekt-vendim "Për miratimin e vlerës së grantit të menjëhershëm për 5 familjet përfituese të programit të subvencionit të interesave të kredisë me vlerë 1.842.784 lekë". Ka kush diçka këtu? Nuk ka. Kartonat, ju lutem. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 6, projekt-vendim "Për miratimin e bursave të nxënësve të regjistruar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026".

Në lidhje me këtë projekt-vendim, fjalën e ka për një sqarim drejtorja përkatëse, sa për dijeni, se nuk prish punë që ta prezantojmë tani, deri këto ditë, drejtori i arsimit, rinisë dhe sportit për bashkinë ishte zoti Keler, ai ka kaluar këto ditë në drejtori tjetër, por meqenëse e ka mbuluar deri tash, ka fjalën që të na sqarojë.

-Keler Sufja: Faleminderit kryetar, vetëm diçka shumë të shkurtër, por kaq të rëndësishme. Ne kemi sjellë listën paraprake të të gjithë përfituesve, ama në moment të fundit një fëmijë i cili është edhe jetim, nuk ka shumë që ka humbur edhe njërin prind, e pamë të arsyeshme, edhe pse është jashtë radhe edhe pse ka kaluar afati praktikisht edhe për kushtet në të cilat është ndodhur, ne ta propozojmë, pastaj i dërgojmë gjithë dokumentacionin përkatës edhe sekretariatit të këshillit bashkiak, për ta përfshirë te kjo listë, për sa kohë ne jemi brenda, po themi, listës totale të propozuar apo të miratuar nga ministria përkatëse. Deri tani ne kemi 79, në dijeninë time, me këtë bëhen 80. Lista totale ka qenë diku 81, kështu që ne jemi brenda, edhe pse thjesht do na duhet për procedurë.

-Ndue Luli: E qartë drejtor. Kush kishte ndonjë diçka në lidhje me projekt-vendimin? Zoti Gjinkola?

-Pjeter Gjinkola: Desha me ditë për sqarim edhe për veten time, a është përfshirë edhe shkolla profesionale?

-Ndue Luli: Kemi tre prej vendimeve të tilla, të lutem dhe t'i dëgjojmë me kujdes. Është e përfshirë edhe ajo.

-Pjeter Gjinkola: Kush nuk ka leje banimi në bashki, s'mund ta përfshijmë. Këtë desha me thënë.

-Ndue Luli: Jo, jo, është tjetër gjë ajo. Atëherë, kush është dakord me projekt-vendimin, ju lutem, kartonat, duke përfshirë edhe propozimin që dha drejtoria përkatëse. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro, faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 7, projekt-vendim “Për miratimin e bursave të nxënësve të klasave të 10-ta të arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2025-2026”. Ka kush diçka? S’ka. Atëherë kartonat. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro, faleminderit.

Pika 8 është projekt-vendim “Për rishqyrtimin dhe miratimin e bursave të nxënësve të viteve të ndërmjetme, të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, për vitin shkollor 2025-2026”. Edhe për këtë, kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 9, projekt-vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. N.M. për djegie banese”. Ka kush diçka? Nga komisioni? S’ka. Atëherë, kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 10, projekt-vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare për përmbytje në banesë z. B.Ll., z. L.D., z. Gj.G., z. P.P., z. B.Rr., z. P.T., z. N.K., z. A.M., z. G.D.”

Në lidhje me këtë, fjalën ka kryetari i komisionit të financave.

-Agostin Marku: Tani nga drejtoria përkatëse duhet të dimë diçka. Në projekt-vendim keni shuma të tjera, në relacion keni shuma të tjera. Ça duhet të marrim për bazë dhe konkretisht që mos të hallakatemi, po i them me iniciale që mos na dalin ndryshe. Te relacioni për L.D-në keni 81.500, te p/vendimi thotë 111.500, e keni të ndryshme edhe te Gj.D, edhe te banori tjetër G.D, po të njëjtën gjë. Na qartësoni, cilën do të marrim për bazë, faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Nga bashkia, drejtoria e emergjencave?

(Flet drejtori i Emergjencave z.Gjergj Prendi)

-Ndue Luli: Në lidhje me këtë, me ndryshimet që duhet të bëhen që ato të jenë të njëjta, si relacionet, si vlerat në projektvendim, kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë në pikën 11, projektvendim “Për krijimin e “Muzeut Arkeologjik Lezhë” në lokalitetin e njohur si “Qafa e Kalasë” dhe pranë “Nekropolit Mesjetar”. Ka dikush ndonjë problem? S’ka. Kush është dakord me projekt-vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Dhe jemi te pika shtesë, e dymbëdhjeta dhe e fundit, projekt-vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-30 Nëntor 2025”. Kush është dakord? E lamë për në fund, se gjithmonë e kemi pasur në fillim, por për vetë faktin që u thashë në fillim. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen, për mendimet që dhatë dhe suksese kryetarit dhe administratës së bashkisë për vënien në efikasitet të plotë të buxhetit.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Floride Guna


KRYETARI

NDUE LULI
